

Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545




The Albanian

VITI I 21 I BOTIMIT 10 PRILL 2025

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

DIASPORA DO TA BËJË MË TË MIRË SHQIPËRINË



PETRIT KUÇANA

**HEKURUDHA,
VOTA DHE
REGJISTRIMI
I DIASPORËS**



ARBEN MANAJ

**SAMITI NË LONDËR
PËR EMIGRANTËT/ QEVERIA
E STARMER NËN PRESION,
BRITANIKËT KËRKOJNË
MARRËVESHJE SI AJO ME
SHQIPËRINË**


**SALMONELA BRAZILIANE
DHE PASAPORTA
EUROPIANE**

LUTFI DERVISHI



**FJALIMET QË
NA MUNGOJNË**

ENVER ROBELLI



**KOMPOZITORI DAVID TUKIÇI I
JEP JETË LEGJENDËS
SHQIPTARE NË PREMIERËN
E OPERËS "ROZAF"**

MAL BERISHA



**RAMA SI PADRON
I KUHËS DHE SHKALLMUES
I KALENDARIT**

ANDI BUSHATI



**SI U FRIKËSUAN
LEXUESIT KOSOVARË
TË "FINANCIAL TIMES"?**


VETON SURROI



E ARDHMJA FILLON TANI

Dotech
websites

**JEPI FRYMËMARRJE
BIZNESIT TËND**



PËR ÇDO KONSULTIM
MUND TE VINI NË
ZYRAT TONA

ADRESA E ZYRAVE:
30 AVENONS ROAD
LONDON E13 8HT

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545


The Albanian newspaper in London

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Kur do i rregulloni hekurudhat në Shqipëri?

Ishte kjo pyetja, që një vajzë shqiptare kërkonte t'i bënte ish-ministrit të Diasporës Pandeli Majko, në një nga takimet e tij në Londër.

Ishte kërkesë e vazhdueshme e vajzës, që ishte e lindur në Britani, pasi ishte vënë shumë në siklet nga shoqet e saj, që kërkonin të përdornin transportin publik, kur shkonin me pushime në Shqipëri.

Pyetja e dytë ishte për plehrat që ishin gjithandej nëpër Shqipëri.

HEKURUDHA, VOTA DHE REGJISTRIMI I DIASPORËS

Ky episod të kujtohet, ndërsa fushata elektorale në Shqipëri ka filluar dhe ku "Shqipëria Europiane" duket se mbetet kryefjalë e kryeministrit. Shkuarja në Europë duket si një pakuptimësi, si fasadë, si tejskajshmëri për aq banorë sa kanë mbetur, që mesatarisht i bie sa një lagje e Londrës, ku Europa mund të ndërtohej (ndërtohet) aty thjeshtësisht.

Imagjini sa ka si kjo shqiptare, e lindur në Angli që gati-gati turpërohet tek shoqet e saj, që vendi i prindërve të saj, nuk ka hekurudhë dhe krejtësisht natyrshëm do të shtrojë pyetjen se kur do të rregulloheshin hekurudhat.

A mund ta bindë kush të votojë për atë Shqipërinë Europiane?

Besohet se ajo vajzë si dhe shumë e shumë të tjerë nuk mund të votojnë, pasi nuk janë të regjistruar kurrë si shtetas të Shqipërisë. Në regjistrimet e fundit diku 48 mijë shqiptarë u penalizuan, megjithë kërkesën e tyre për të votur, duke bërë të dështojë sistemi dhe institucionet që nuk mund tu

garantojnë të drejtën e votës qytetarëve shqiptarë në vendet ku jetojnë. 48 000 janë shumë për një Shqipëri (mund të quhen edhe përcaktues?). Shumëkush e konsideroi si sukses rreth çerek milioni shqiptarë të diasporës të regjistruar.

Ndërkohë që fushata ka nisur, në Gjermani, si pasojë e ndryshimeve të legjislacionit atje, me mijëra shqiptarë kërkojnë të ri-marrin shtetësinë shqiptare. Krejtësisht tragji-komike bëhet situata, kur askush nga institucionet nuk ka ide se si duhet të vepohet me ta.

(Qytetarët shqiptarë janë detyruar të dorëzojnë shtetësinë shqiptare pak vite më parë, duke e marrë atë gjermane, pasi Gjermania nuk e lejonte në atë kohë dështetësinë. Tani pas ndryshimeve legjislative mund ta mbajnë edhe nënshetësinë shqiptare, por askush nuk u përgjigjet. Ambasada i sorollat për tek Ministria e Brendshme dhe nga atje i çojnë tek Ministria e Jashtme. E sërish asgjë nuk zgjidhet.

Sërish askush nuk e vë ujën në zjarr të marrë ndonjë masë për këtë kërkesë

kaq normale të shqiptarëve në Gjermani.

As edhe një institucion nuk guxon të bëzajë, të psherëtitjë... por me heshtje mbulohet gjithçka. Nëse në atë kohë kishte një Ministër Shteti për Diasporën, megjithë joefiçencën e tij, ishte një si tip adrese nga ku shkonin kërkesat e shqiptarëve të diasporës. Me shuarjen e kësaj ministrie, diaspora nuk ka një 'dritare' ku të ankohet. Mbase askush nga ata shqiptarët e Gjermanisë, (mbase edhe gjetkë), nuk e di që ekziston një KKD (Këshilli Koordinues i Diasporës) që mjerisht janë disa njerëz të përzgjedhur nga qeveria, që ekspozohen prej qeverisë si 'përfaqësues të diasporës', por që fatkeqësisht nuk kanë mundur të jenë avokatë të shqiptarëve të diasporës. E ku tjetër mund të ankohen këta shqiptarët e Gjermanisë?

Po ata shqiptarët e shteteve të tjera që për një mijë e një arsye nuk janë regjistruar në regjistrin themeltar të Shqiptarisë, edhe për shkak të pamundësisë së kohës fizike apo të pengesave të njëpasnjëshme nga insti-

tucionet...

Po ata shqiptarë të diasporës, që janë në listën e kontributorëve (të remitan-cave) 1 miliard euro për familjet e tyre në Shqipëri, por që kurrë nuk u është dashur një dokument i shtetit shqiptar?

Sa dekada i duhen një force politike në pushtet për të regjistruar qytetarët e vet?

Sa e vështirë është që të regjistrohesh sot fëmijët që lindin në emigracion? Nëse për shqiptarët e Brianisë ka rrethana specifike, çfarë ndodh me shqiptarët nëpër shtetet e tjera?

Sa herë u premtua se sidomos gjatë verës do të kishte në çdo bashki një zyrë vetëm për diasporën...

Diaspora a mbetet totalisht e pashfrytëzuar, mjerisht edhe për kapacitetet e saj.

Sinergjia e diasporës shqiptare do të mund të ishte transformuese e jashtëzakonshme e Shqipërisë... por tani për tani mjerisht mjafton vetëm vota e saj...

Dotech
website

“ **AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ?** ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT




The Albanian

You **Talk**
We **Listen.**

4.9^{/5}



Because your case isn't just another file — it's your life.



**Secure
your right
to work,
live and be
FREE in the
UK.**



Meet

OLIVERTA MEDIU

Solicitor, Partner

+44 (0)20 7063 9040

Call now to book your confidential consultation!

079 4603 5736

o.mediu@wslegal.co.uk

Leicester Office:
3rd Floor, St. George's House, 6 St George's
Way, Leicestershire, LE1 1QZ, UK

Head Office:
2nd Floor, 2-5 Minories,
London EC3N 1BJ

Immigration Law:

- Visa applications & appeals (work, student, spouse, etc.)
- Indefinite Leave to Remain (ILR) & British citizenship
- Asylum & human rights claims
- Detention, bail, and deportation defense
- Sponsorship & business immigration

Family Law:

- Divorce & separation
- Child custody & visitation rights
- Domestic violence protection orders
- Prenuptial & postnuptial agreements

Providing expert legal support to all—
regardless of race, nationality, age, gender, or identity.



ARBEN MANAJ

Jane keshilltaret e sigurise ne Britani qe kane paralajmeruar mbi nevojen qe britaniket e thjeshte te pergatiten qe tani per pasjen neper shtepite e tyre te nje "pakete mbijetese e cila do duhet per nje periudhe prej 72 oresh" ne kushtet kur Putini planifikon te kryej akte sabotazhi ndaj tubacioneve te gazit qe furnizojne Britanine.

Ne kete pakete mallrash te emergjences perfsihen uji i pijshem, ushqim i konservuar dhe me jetegjatesi, ilace, nje radio me bateri, elektrik dore, dokumentat e identiteti, dhe nje thike e ushtrise zvicerane. Shqetesimi se ruset jane duke planifikuar akte sabotazhi, nisur nder te

tjera edhe nga qendrimi britanike ndaj luftes ne Ukraine, eshte pershkallezuar qe kur anije e spiunazhit rus Yantar, eshte zbuluar duke bere skanimin e infrastrukturen nenujore kritike detare me Detin e Veriut.

Britanai siguron 40 per qind te furizimeve te saj me gaz nga Norvegjia, permes tubacionit prej 700 miljeshste gjate te quajtur Langeled.

Nderkohe The Sunday Times e Londres, kete te djele njofton se sensore rus te cilet dyshohet se spiunojne nendeteset berthamore britanike jane zbulura te fshehura ne ujrat detare qe rrethojne Britanine e Madhe.

Zbulimi nga ushtria britanike po konsiderohet si nje kercenim potencial per sigurine kombetare dhe eshte hera e pare qe behet publik.

Hetimi tre mujor i The Sunday Times, ka mesuar se Britania ka zbuluar mjete detare nenujore pa njerez ne afersi te kablllove nenujore ne thellesi te medha . Po ashtu Ministria e Mbro-

BRITANIA E MADHE, NË ALARM NGA SABOTAZHI I PRITSHËM RUS!



jtjes ka informata te besueshme te inteligjences se superjahtet e oligarkeve rus mund te jene perdorur

per rikonicjonin nenujor.

Ky aktivitetet i Rusise ne ujrat bri-

tanike ka bere qe ushtria ta ngrrej shqetesimin deri ne nivelet me te larta te politikës britanike.

Dotech
website

Për çdo konsultim mund të na kontaktoni ose mund te vini në zyrat tona

- BUSINESS CARDS
- LOGO
- BANNERS
- POSTERS
- VIDEO MARKETING



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

ZYBER

Your one-stop destination for all needs.

Smashing prices

Super çmime, për më shumë visitoni dyqanet tona!

Paint mixing in stores 10,000 colours available.

<p>Dulux Trade Supermatt White 10L</p>  <p>£33.32 Ex. VAT</p>	<p>Dulux Trade Vinyl Matt Pure Brilliant White 7.5L</p>  <p>£25.81 Ex. VAT</p>	<p>Dulux Trade Vinyl Matt White 10L</p>  <p>£41.65 Ex. VAT</p>	<p>Dulux Trade Diamond Matt Pure Brilliant White 10L</p>  <p>£72.48 Ex. VAT</p>	<p>Leyland Contract Matt Brilliant White 10L</p>  <p>£18.50 Ex. VAT</p>	<p>Leyland Trade Vinyl Matt Emulsion Brilliant White 10L</p>  <p>£29.98 Ex. VAT</p>
<p>Leyland Trade Super Leytex Matt Brilliant White 15L</p>  <p>£22.48 Ex. VAT</p>	<p>Leyland Trade Acrylic Eggshell Brilliant White 5L</p>  <p>£30.81 Ex. VAT</p>	<p>Johnstones Trade Jonmat Premium Contract Matt Brilliant White 10 L</p>  <p>£23.75 Ex. VAT</p>	<p>Johnstones Trade Covaplus Vinyl Matt Brilliant White 10L</p>  <p>£29.98 Ex. VAT</p>	<p>Johnstones Trade Covaplus Vinyl Matt Brilliant White 5L</p>  <p>£21.65 Ex. VAT</p>	<p>Johnstones Trade Acrylic Eggshell Brilliant White 5L</p>  <p>£38.31 Ex. VAT</p>
<p>Crown Vinyl Matt White 7.5L</p>  <p>£19.98 Ex. VAT</p>	<p>Crown Trade Clean Extreme Matt White 5L</p>  <p>£29.98 Ex. VAT</p>	<p>Crown Trade Quick Dry Fastflow Satin White 5L</p>  <p>£29.15 Ex. VAT</p>	<p>Macpherson Eclipse Emulsion Brilliant White 15L</p>  <p>£21.65 Ex. VAT</p>	<p>Macpherson Eclipse Matt 15L Magnolia</p>  <p>£21.65 Ex. VAT</p>	<p>Macpherson Durable Acrylic Matt Brilliant White 5L</p>  <p>£22.48 Ex. VAT</p>
<p>Macpherson Vinyl Matt Paint Brilliant White 10 L</p>  <p>£20.98 Ex. VAT</p>	<p>Armstead Trade Contract Matt White 10L</p>  <p>£20.81 Ex. VAT</p>	<p>Dulux Trade Quick Dry Gloss Pure Brilliant White 5L</p>  <p>£44.15 Ex. VAT</p>	<p>Dulux Trade Diamond Matt Pure Brilliant White 5L</p>  <p>£34.98 Ex. VAT</p>	<p>Leyland Acrylic Primer Undercoat White 5L</p>  <p>£24.50 Ex. VAT</p>	<p>Crown Trade Fastflow Quick Dry Gloss White 5L</p>  <p>£28.31 Ex. VAT</p>
<p>Dulux Trade Quick Dry Wood Primer Undercoat 5L</p>  <p>£55.81 Ex. VAT</p>	<p>Zinsser BIN Aqua 2.5L</p>  <p>£49.98 Ex. VAT</p>	<p>Gyproc Easifill 60 Filler & Jointing Compound 10Kg</p>  <p>£19.98 Ex. VAT</p>	<p>Ronseal High Performance Wood Filler, White, 3.7 kg</p>  <p>£33.31 Ex. VAT</p>	<p>Uniwipe x6 Ultra Grime Ultragrim Industrial Multi-Purpose Cleaning Wipes X100</p>  <p>£49.89 Ex. VAT</p>	<p>Uniwipe X6 Ultragrim Textured Power Scrub Surface Cleaning Hand Wipes X80 Pack</p>  <p>£59.98 Ex. VAT</p>

WHY US?

✓ Expert service

✓ Delivery In UK

✓ Open 7 days a week

FIND US

1342 Greenford Road, Greenford, UB6 0HL

0207 387 5328

168 Kentish Town Rd, Camden Town, NW5 2AG

0207 482 2722

76 Elmers End Road, Beckenham, SE20 7UX

0208 778 4222

49-51 Fulham High Street SW6 3JJ

0207 736 8153

73 Chase Side Southgate London N14 5BU

0208 882 2490

57 Wembley Hill Road, London, HA9 8BE

0204 537 4791

52 Northcote Rd, Clapham, London SW11 1PA

0203 093 1646

Unit 6 Grand Union Trade Park Abbey Road, London, NW10 7UL

www.zyberltd.co.uk

ZYBER LTD

zyberltd

zyber.ltd

Zyber Ltd

zyber.ltd

ARBEN MANAJ

Autorizimi elektronik i njohur si ETA nuk është vize dhe nuk të lejon ne vetevete hyrjen ne Britani, pasi është një leje dixhitale për të udhëtuar drejt Britanise, e cila pas aprovimit i ataxhohet në menyre elektronike pas-aportes se udhetarit.

Por për këtë autorizim, që kushton momentalisht vetëm 10 sterlina për të aplikuar por që mund të shkojë në 16 pas javës së ardhshme, nuk kanë nevojë të kesh ETA ose autorizimin dixhital; nëse ke vize, nëse ke leje për të jetuar dhe punuar apo studiuar në Britani, përfshi këtu ata që kanë status ose parastatus qëndrimi si shtetas të BE-se, apo që kanë të drejtën e banimit në Britani.

Po ashtu nuk kanë nevojë për këtë autorizim ata që kalojnë tranzit nga

KUSH UDHËTON DREJT ANGLISË, PAGESË SHITESË: NJËSOJ SI NË SHBA, SI JEPET AUTORIZIMI!

aeroportet britanike dhe nuk kalojnë përmes kontrollit kufitar. Por gjithësesi këshillohet që të verifikohet me linjat ajrore të udhëtimit nëse udhëtarët nuk janë të sigurt. Nuk ke nevojë për këtë autorizim nëse je shtetas britanik ose irlandez. Menyra më e mirë për të aplikuar për marrjen e ETA-s është përmes aplikacionit UK ETA, ose përmes uebsajtit të qeverisë britanike.

Zakonisht autorizimi jepet brenda disa minutash, në rastet kur bëhet përmes aplikacionit megjithatë udhëtarët këshillohen t'i japin tre ditë kohë vetes pasi një numër i vogël rastesh kërkojnë procedurë të met-



jeshme.

Aplikimi për marrjen e autorizimit

dixhital, i njëti si ai kur udhëton në Shtetet e Bashkuara, përfshin pagesimin e tarifës, dhenien e të dhenave të kontaktit dhe pasaportës, një foto të vlefshme dhe përgjigjen e disa pyetjeve. Për atë kohë sa aplikon përpara udhëtimit, mund të udhëtohet drejt Britanise ndërkohë që pritet vendimi.

Kjo leje elektronike ka afat dy vjeçar dhe të lejone të udhëtosh shumë here drejt Britanise brenda kësaj periudhe dy vjeçare dhe për qëndrime deri gjashtë muaj brenda kësaj periudhe dy vjeçare ose derisa të skadojë pasaporta.

Për të kuptuar rëndësinë e këtij samiti të paprecedentë për migracionin ilegal dhe luftën kundër trafikimit të organizuar kriminal, mjafton t'i referohesh shifrave të kryeministrit Starmer, i cili sot në Londër në Samit tha se Britania ka rikthyer në vendet e tyre 24 mijë persona që nuk do duhej të jetonin në Britani që kur erdhën në pushtet para 8 muajsh.

Ndërkohë, Starmer nuk përmendi se rreth 30 mijë emigrantë të rinj kanë mbërritur që nga qershori i kaluar në brigjet angleze me 542 gomone, ku vetëm në tre muajt e parë të këtij viti kanë mbërritur mbi 6 mijë e 500 emigrantë të tjerë.

Këto shifra tmerrojnë britanikët e thjeshtë, që ishte një nga arsyt përse votuan largimin e konservatorëve nga pushteti dhe dhenien e një shansi laburistëve.

SAMITI NË LONDËR PËR EMIGRANTËT/ QEVERIA E STARMER NËN PRESION, BRITANIKËT KËRKOJNË MARRËVESHJE SI AJO ME SHQIPËRINË

Dhe sondazhet janë të vështira për t'u lexuar nga laburistët dhe britanikët; për momentin i kanë hedhur sytë nga Partia Reforma e babait të Brexit, Nigel Farage, me qëndrim mjaft të ashpër kundër emigracionit.

Kryeministri kërkoi bashkëpunim ndërkombëtar nga çdo vend në këtë luftë vitale për sigurinë ndërkombëtare.

Interesant ishte fakti se ai përmendi Vietnamin dhe Shqipërinë në fjalën e tij hyrëse si raste bashkëpunimi në këtë luftë, ku një pjesë shumë e madhe e të kthyerve janë nga marrëveshja me Shqipërinë e vitit 2023



mes Ramës dhe Sunak.

Britanikët dukshëm janë gjithnjë e më vokalë në dëshirën për një variant të

tyre të skemës deportuese të Ruandës, e iniciuar nga Boris Johnson, që laburistët e kanë braktisur, pasi sipas Starmer, 700 milionë sterlina u harxhuan për vetëm 4 emigrantë të rikthyer vullnetarisht.

Mbetet enigme nëse britanikët do të duan të avancojnë me idenë e ngritjes së qendrave në vende të tjera për përpunimin e kërkesave për azil të atyre që mbërrijnë në Britani, pak a shumë si ajo me Shqipërisë dhe Italisë, dhe nëse kjo ide do të ngrihet me përfaqësuesit zyrtarë të Shqipërisë në samitin e Londrës. Shqipëria deri më sot e ka hedhur poshtë një ide të tillë.

ARBEN MANAJ

Justifikimi me detin e qetë në ujërat e ngushticës mes Francës dhe Anglisë, për shtimin e numrit të të ardhurve me gomone drejt brigjeve angleze, është një muzikë e njohur e luajtur edhe nga konservatorët e qendrës së djathtë tashmë në opozitë në Britani.

Ky avaz, duket se hedh poshtë dhe zhbën, financimet deri në afro një miliardë sterlina që Londra i jep Parisit për të frenuar kalimet ilegale dhe të rrezikshme në ngushticën rreth 35 km në Kanalin anglez apo La Mansh sipas francezeve. Që nga ardhja e laburistëve në pushtet, shifra e kalimeve e ka kaluar tashmë 20 mijë vetëve, dhe asnjëri prej tyre nuk është quajtur pushtues, si dikur shqiptarët përpara dy vjetësh, në numra më të lartë sesa aktualisht nëpër këto gomone.

Sipas qeverisë aktuale periudha 31 di-

tore mes tetorit dhe nëntorit ka pasur numrin më të lartë të ditëve të qeta në lundrim të njohura si "red days", kur kushtet atmosferike bëjnë më të mundshme ose shumë të mundshme kalimin e ngushticës me gomone.

Për të njëjtën periudhë kohore të vitit të kaluar, nga 768 vetë të mbërritur, këtë vit shifra ishte në 6288 vete, rreth dhjetë herë më shumë. Ndërkohe 122 vetë kanë mbërritur gjatë fundjavës. Këto shifra dalin në kohën kur Ministria e Brendshme britanike do njoftojë një marrëveshje të arritur me qeverinë e Irakut për bashkëpunimin në luftën kundër grupeve të trafikantëve dhe shtimin e rikthimeve të të mbërriturve drejt

ANGLI, 20 MIJË TË ARDHUR ME GOMONE! SHIFRAT PASI STARMER FITOI ZGJEDHJET NË BRITANI, SHKAK LA MANSHI "I QETË"



Irakut.

Ndërkohe luftimet në Siri nuk për-

bëjnë lajm të mirë edhe pse ato po ndodhin kur dimri sapo ka trokitur. Laburistët dukshëm, ashtu si edhe konservatorët nuk po kanë një plan dhe afate të qarta se kur do mund dhe si do mund jo vetëm të frenojnë, por edhe rikthejnë të ardhurit, të cilët me shumë gjasa do vazhdojnë të qëndrojnë në ishull, pasi nuk pranohen nga shumica e vendeve nga vijnë dhe nuk kanë të ndalur.

Madje laburistët nuk është se po lenë të nënkuptohet se do ketë ndonjë amnistie të mundshme në të ardhmen. Në kushte të tilla kalimet po vazhdojnë dhe laburistët janë në po të njëjtin hall si edhe konservatorët, totalisht të pafuqishëm për të ndryshuar situatën.

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Akoma nuk jeni
regjistruar në Google?

Dotech
website 

NA KONTAKTONI

Our Services:

- **Business Cards**
- **Logos**
- **Banners**
- **Video Marketing**

PËR ÇDO KONSULTIM
MUND TË VINI NË ZYRAT TONA

30 Avenons Road
London E13 8HT



TEL: 020 7018 7929
MOB: 073 4066 5946
MOB: 078 5997 7545

“KUSH S’E KA NJOHUR KOSOVËN, TA BËJË SA MË SHPEJT”, AMBASADORI BRITANIK NË KS “ULTIMATUM”: SERBIA TË JAPË LLOGARI PËR SULMIN NË BANJSKË!

Përfaqësuesi i Mbretërisë së Bashkuar në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara tha se si përkrahës i shtetësisë së Kosovës, mirëpresin njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Kenia, teksa i inkurajoi të gjitha shtetet që s’e kanë bërë, ta bëjnë sa më parë.

“Si përkrahëse e shtetësisë së Kosovës, e mirëpresim njohjen së voni të Kenias. Inkurajojmë të gjithë ata që s’e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, ta bëjnë këtë sa më shpejt. Derisa raporti i Sekretarit të Përgjithshëm thekson shumë faktin që ka presion tek serbët në Kosovë, janë përpjekjet e suksesshme të Kosovës për të rekrutuar policë nga komuniteti serb. Shprehim keqardhje që gjyqtarët dhe prokurorët nga komunitetet joshumicë nuk kanë kërkuar që të rikthehen në institucionet e Kosovës”, tha përfaqësuesi britanik.

Më tej, ai tha se inkurajojnë Kosovën dhe Serbinë që të angazhohen në mënyrë konstruktive në dialog, për të arritur një marrëveshje normalizuese dhe ligjrisht obliguese.

“Mirëpresim pjesëmarrjen aktive të serbëve të Kosovës në zgjedhjet paqësore komunale në periudhën e ardhshme dhe inkurajojmë Kosovën dhe Serbinë që të angazhohen në mënyrë konstruktive me Sorensenin për të arritur një marrëveshje normalizuese dhe ligjrisht obliguese duke zbatuar plotësisht edhe marrëveshjet e Brukselit dhe Ohrit”, tha ai.

Më tej, përfaqësuesi i Britanisë i kërkoj Serbisë që të dërgojë para drejtësisë autorët e sulmeve të KFOR-



it, atij në Banjskë dhe të bashkëpunojë me Kosovën për t’i identifikuar autorët sulmit në kanalën e Ibër-Lepencit.

“I kërkojmë Serbisë që të sjell para drejtësisë gjithë ata që janë përgjegjës për sulmet e KFOR-it dhe sulmin në Banjskë dhe të bashkëpunoj për të

hetuar dhe identifikuar ata që e kanë kryer sulmin në Ibër-Lepenc”.

“Duke marrë parasysh kushtet në terren që s’janë aspak të afërta me vitin 1999, kërkojmë rishikimin e rolit të UNMIK-ut për të siguruar që të vazhdojë përkrahja për stabilitet dhe siguri në Kosovë, por që reflekton botën e vitit 2025”, tha ai.

Përfaqësuesi i Rusisë e akuzoi Kosovën për “vazhdimin e politikës së saj drejtë debimit të banorëve serbë” pasi Kosova, ndër të tjera, ndaloi përdorimin e dinarit serb.

Ai shtoi se Bashkimi Evropian nuk

është në gjendje të ndikojë mbi Prishtinën, duke theksuar se ndërmjetësimi i BE-së ka dështuar plotësisht në dialog.

Përfaqësuesi i Bashkimit Evropian u bëri përsëri thirrje Kosovës dhe Serbisë të fillojnë zbatimin e Marrëveshjes se vitit 2023 për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve.

“BE-ja e mirëpret faktin që Kosova dhe Serbia ritheksuan përkushtimin e tyre ndaj dialogut të lehtësuar nga BE-ja dhe për procesin e normalizimit të marrëdhënieve dhe zotimin e tyre për angazhim konstruktiv në proces për të ecur përpara shpejt”, shtoi ai.

Ai shtoi se nga Kosova pritet themeli i Asociacionit, ndërsa nga Serbia njohja e dokumenteve dhe simboleve të Kosovës.

ENVER ROBELLI

Rrallëherë (ose gati asnjëherë) politikanët e Kosovës ia dalin të mbajnë një fjalim vërtet shtetëror, të kuptueshëm dhe inspirues për sistemin demokratik. Para se Kuvendi i Kosovës të fillojë legjislaturën e re, që një propozim se ku do të duhej të orientohet dhe të mësonte kryetari apo kryetarja e re e Parlamentit të Kosovës.

Fillimi i punës së parlamentit të ri nuk është një punë sa për sy e faqe. Negociatat për krijimin e qeverisë nuk janë çështje vetëm e ndarjes së posteve. Së pari dhe më e rëndësishme është marrëveshja për koalicionin dhe harmonizimi i programeve mes partive që duan të krijojnë qeverinë. Në të kaluarën kemi parë në Kosovë një letër të formatit A4, e cila i përmbante disa pika të përgjithshme dhe kryesisht me përmbajtje boshe. Kjo quhej marrëveshje për koalicionin. Ishte mesazh i qartë ndaj elektoratit: Harrojeni çfarë kemi premtuar gjatë fushatës elektorale! Prioritet ka ndarja e posteve.

Më ra të shikoja, të dëgjoja dhe të lexoja fjalimin e kryetares së re të Parlamentit të Gjermanisë. Julia Klöckner, deputete shumëvjeçare dhe politikane me përvojë e partisë konservatore CDU, u zgjodh më 25 mars. Fjalimi i saj – me rreth 20 mijë karaktere – zgjati afër gjysmë ore.

Dhe në pjesën më të madhe ishte vërtet inspirues, solemn, dinjitoz, largpamës, vetëkritik, këshillues dhe paralajmërues. Rrallëherë (ose gati asnjëherë) politikanët e Kosovës ia dalin të mbajnë një fjalim vërtet shtetëror, të kuptueshëm dhe inspirues për sistemin demokratik. Para se Kuvendi i Kosovës të fillojë legjislaturën

e re, që një propozim se ku do të duhej të orientohet dhe të mësonte kryetari apo kryetarja e re e Parlamentit të Kosovës. Le ta lexojë fjalimin e Julia Klöckner.

Në fillim të fjalimit të saj, ajo tha se zgjedhja në një post publik është më pak nder dhe më shumë detyrë apo obligim. Pas-taj paralajmëroi se si do të sillet si kryetare e Bundestagut, siç quhet Parlamenti gjerman: “Kam vullnetin e fortë ta përmbush detyrën që më është besuar gjithmonë në mënyrë të paanshme, pa panik dhe e paturbur – e qartë në çështje, por gjithashtu përbashkuese në marrëdhëniet me të tjerët”.

Mandej vazhdoi: “Mbikëqyrja e kohës së fjalimeve nga karrigia e kryetares (së Parlamentit) është e lehtë; për këtë qëllim ka një orë. Por unë nuk do të shikoj vetëm orën, do të dëgjoj gjithashtu – si në foltore, ashtu edhe në sallë. Për këtë kam një masë të qartë: mirësjelljen. Duhet të zhvillojmë debat të ashpër, atë debat duhet ta përballojmë, ta durojmë – po, kjo është pjesë e punës – sipas rregullave të qarta, procedurave të qarta dhe shumicave të qarta.

Do të sigurohem që të ruajmë një sjellje të civilizuar ndaj njëritjetrit dhe, nëse nuk e bëjmë këtë, duhet të mësojmë ta bëjmë këtë. Po, është i rëndësishëm stili i debatit dhe respekti në marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Mënyra se si komunikojmë dhe shkëmbejmë argumente këtu – për këtë jam e bindur – ndikon në debatet shoqërore. Ne po përpiqemi këtu në



seancë plenare për të gjetur zgjidhje për problemet që trazojnë vendin tonë”. Fjalimi përmban edhe shumë formulime të tjera me vlerë: “Konstituiimi i parlamentit të ri është gjithmonë po ashtu një moment solemn. Është një ngjarje që lidh vazhdimësinë me risinë, me përtëritjen”

Nganjëherë njerëzit sikur harrojnë se nuk është e vetëkuptueshme të zgjedhësh në mënyrë demokratike dhe të dërgosh në parlament njerëz që përfaqësojnë vullnetin e qytetarëve të lirë. Mbi 70 për qind e popullsisë së botës jeton në shtete me forma autokratike apo gjysm-autokratike shtetërore – tha Klöckner. Këtë do të ishte mirë ta kishin të qartë politikanët dhe shoqëria kosovare. Secili shtet ka një qeveri, por jo çdo shtet ka opozitë. Ekzistenca e opozitës e bën demokracinë të vërtetë.

Gjermaninë (AfD), e cila nga drejtësia gjermane është shpallur pjesërisht ekstremiste. Asnjë nga partitë e etabluara nuk është e gatshme të bashkëpunojë me AfD-në. Por është e pamundur të injorohet krejtësisht kjo parti, e cila në zgjedhjet parlamentare të mbajtura në shkurt doli e dyta. Duke i pasur në mendje ndryshimet në peizazhin politik, kryeparlamentarja gjermane në fjalimin e saj theksoi: “Shumica nuk ka automatikisht të drejtë, por as pakica. Le të kritikojmë njëri-tjetrin, kjo është pjesë e procesit. Por të mos e denigrojmë njëri-tjetrin në mënyrë personale.

Ne nuk zëmë në thua vetëm sepse bëjmë një hap drejt njëritjetrit. “Të mos bëjmë gabimin të dyshojmë në aftësitë mendore apo në vullnetin e mirë të çdo personi me mendim të ndryshëm”. Kjo nuk është thënie imja, por e (ish-kancelarit nga fundi i

“Demokracia do të thotë – nga ‘Demos’, popull – pra, sundim i popullit. Nuk sundojmë ne, por populli na ka ngarkuar me këtë detyrë”, – shtoi kryetarja e re e Parlamentit gjerman në vazhdimin e fjalimit të saj. Me dekada të tëra, shoqëria gjermane u ka rezistuar ekstremizmave politikë. Partitë e etabluara kanë bashkëpunuar me njëra-tjetrën, duke i mbajtur larg armiqtë e demokracisë. Por në 10 vjetet e fundit arena politike ka ndryshuar me forcimin e partisë së djathtë Alternativa për

shekullit të 19-të) Otto von Bismarck”. Një demokraci parakusht për ecje përpara është kompromisi. Kanë sukses afatgjatë vetëm ata politikanët që kur fillojnë të kërkojnë një zgjidhje e kanë parasysh se edhe pala tjetër mund të ketë të drejtë në ndonjë pikë. Dhe pikërisht këtë pikë duhet integruar në zgjidhje. Në këtë frymë ishte i ndërtuar fjalimi i Julia Klöckner. Asnjë parlament nuk është i përsosur. S’mund të jetë, sepse as shoqëritë nuk janë të përsosura. Por kjo s’do me thënë që duhet të heshtin problemet.

Kryeparlamentarja gjermane përmendi përfaqësimin joadekuat të grave në shtëpinë e përfaqësuesve të popullit. “Gratë përbëjnë më pak se një të tretën e deputetëve.

Megjithatë, më shumë se gjysma e shoqërisë sonë përbëhet nga gratë. Një parlament që flet për të gjithë duhet të përfaqësojë në mënyrë të përshtatshme grupet shoqërore dhe kjo, kur bëhet fjalë për gjinitë, është ende diçka që nuk është arritur kudo plotësisht. Sepse që nga viti 1918, ligji zgjedhor nuk ua ka ndaluar grave të kandidojnë, megjithatë, kushtet duket se e bëjnë ende këtë”.

Për të rritur përfaqësimin e grave në parlament duhet përmirësuar kushtet. Dhe në fund të këtij teksti, një propozim:

Duke u bazuar te praktika gjermane, Parlamenti i Kosovës mund të bëjë një ndryshim të Rregullores së Punës dhe t’ia japë të drejtën për drejtimin e seancës së parë deputetit me stazhin më të gjatë dhe jo, si deri më tani, deputetit më të moshuar. Krejt kjo për çështje efikasiteti në punë.

FJALIMET QË NA MUNGOJNË

**TRANSPORT
APOLLONIA**



**TRANSPORT
MAKINASH
ANGLI-SHQIPËRI**

00447429200952

**OFRON SHERBIME TRANSPORTI
MAKINA
MOTORCIKLETA
PJESË MAKINASH
MAKINERI BUJQËSORE
MOBILJE
FASADA XHAMI
DYER & DRITARE, MOBILIERI ETJ**



00355682948843

00355694031009

00447429200952

**TRANSPORT MALLRASH
ANGLI-SHQIPËRI
SHQIPËRI-ANGLI**



www.transportapollonia.co.uk



REL

DIASPORA E KOSOVËS, POTENCIALI I PASHFRYTËZUAR PËR DIPLOMACI

Diaspora e Kosovës është një aset i fuqishëm, por i pashfrytëzuar në forcimin e pozitës ndërkombëtare të vendit, thonë njohësit e kësaj fushe. Dikur forcë lëvizëse e përpjekjeve për pavarësi, sot potenciali i saj mbetet i fragmentuar, sipas tyre.

Me një “potencial të jashtëzakonshëm”, diaspora e Kosovës mund të bëhet faktor në forcimin e pozicionit ndërkombëtar të vendit, por i mungon kauza e unifikuar dhe koordinimi i mirëfilltë, thonë vëzhguesit e veprimtarisë së saj.

Lirim Krasniqi, analist i politikave në organizatën Germin, thotë se “politikë dhe strategjitë duhet të vijnë nga Kosova” dhe të tillat, sipas tij, mungojnë.

Më konstatimin e tij pajtohet edhe ish-zëvendësministri i Jashtëm i Kosovës, Valon Murtezaj, aktualisht ligjërues i Diplomacisë në Shkollën e Menaxhmentit IESEG në Paris.

Sipas tij, Kosova nuk e shfrytëzon siç duhet potencialin e diasporës së saj për të hapur shtigje të reja për diplomaci, në të mirë të vendit.

“Kjo nuk do të thotë se nuk ka veprimtari. Por, veprimtaria e diasporës, e individëve të shquar, e grupeve të ndryshme – qofshin biznesmenë, akademikë, njerëz të kulturës dhe artist – mbetet e fragmentuar dhe e izoluar”, vlerëson Murtezaj për Radion Evropë e Lirë.

Në regjistrimin e fundit të popullsisë në Kosovë, në vitin 2024, për herë të parë u përfshinë edhe kosovarët që jetojnë në diasporë.

Prej tyre, u regjistruan rreth 550 mijë, sipas të dhënave që publikoi Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Por, besohet se numri i personave me prejardhje nga Kosova, që jetojnë në diasporë, është shumë më i lartë, vetëm se ata nuk e kanë shtetësinë kosovare.

Cili ishte dhe është roli i diasporës në diplomaci? Viteve të fundit, diaspora ka luajtur rol në ndarjen e ulëseve në Kuvendin e Kosovës, përmes votës.

Për zgjedhjet e fundit parlamentare, që u mbajtën më 9 shkurt, u regjistruan afro 105 mijë votues nga diaspora, prej të cilëve votuan rreth 80.000 – disa në përfaqësi diplomatike, të tjerët me postë.

Partitë kryesore politike, para dhe gjatë fushatës zgjedhore, organizuan disa tubime me kosovarët në diasporë – sidomos në Evropë – duke kërkuar mbështetje për vota.

Profesori Murtezaj thotë se, marrë parasysh potencialin e madh të diasporës, qasja e partive dhe institucion-

eve të Kosovës ndaj saj është paradoksale, sepse ajo shihet vetëm si burim votash.

“Votimi është minimumi që mund ta bëjë individi. Angazhimi dhe bashkëpunimi do të duhej të ishin shumë përtej kësaj, sepse zgjedhjet janë një ditë në katër vjet, ndërsa kontributi potencial i diasporës është 365 ditë apo tërë jetën”, thotë Murtezaj.

Ai vlerëson se shembulli më i mirë i fuqisë së veprimit të diasporës është periudha e viteve '90. Asokohe, Kosova gjendej nën regjimin serb të Sllobodan Millosheviqit, aparati shtetëror i të cilit ushtroi dhunë dhe lapa punë shumicën e madhe të kosovarëve.

Gjatë asaj kohe, remitencat nga diaspora ishin ndër burimet kryesore të mbijetesës për shqiptarët e Kosovës, të cilët organizuan institucionet e tyre paralele. Edhe këto lëvizje politike në atë periudhë financoheshin kryesisht nga diaspora, e cila lobonte për çështjen e Kosovës gjatë në botë.

Avni Spahiu, ish-ambasador i Kosovës në Shtetet e Bashkuara dhe në Turqi, e përshkruan si të pazëvendësueshëm rolin e diasporës shqiptare në SHBA për çështjen e Kosovës, gjatë viteve 90. Ai thekson se diaspora mund ta luajë këtë rol edhe sot, në kohën kur “lobimi në Uashington është në pikën më të ulët”.

Përmes diasporës, ai thotë se Kosova mund të iniciojë riformatimin e “grupit shqiptar të miqësisë”, që aktualisht mungon në Kongresin amerikan, por që dikur përbëhej nga kongresistë si: Eliot Engel, Tom Lantos, Bob Dole e të tjerë.

“Tash, sa mund të bëjë diaspora? Ata janë edhe amerikanë dhe kanë të drejtë të kërkojnë të kontaktojnë me Kongresin, ta bëjnë ‘grupin e miqësisë’. Tash kemi nevojë”, thotë Spahiu për Radion Evropë e Lirë.

Ai shton se diaspora e Kosovës ka individë me ndikim që mund të ndihmojnë në krijimin e “grupeve të miqësisë” edhe në parlamentet e vendeve të tjera perëndimore.

Gjatë viteve '80 dhe '90, në vendet perëndimore ekzistonte shumë shoqata, klube dhe organizata të tjera të diasporës së Kosovës, që operonin



kryesisht mbi bazën e angazhimit vullnetar.

Krasniqi, nga organizata Germin, thotë se ato ishin pikëtakime jo vetëm për ruajtjen e kontakteve ndërmjet shqiptarëve të Kosovës, por edhe për organizimin e ndihmave financiare për vendin, si dhe për krijimin e lidhjeve me kanalet politike dhe diplomatike të vendeve ku jetonin.

Sipas tij, shoqata e organizata të tilla ekzistojnë edhe sot, por nuk mund të pritet që të veprojnë siç vepruan në vitet '90.

Kauza që i bashkonte në atë kohë, ishte lufta për demokraci dhe pavarësi të Kosovës nga ish-Jugosllavia, veçanërisht nga Serbia, sipas Krasniqit.

“Atëherë, kauza ishte e përbashkët dhe të gjithë vepronin me forca vetanake, duke e ditur mungesën e një shteti që do t'i orientonte dhe organizonte. Sot, nuk mund të pritet një organizim i tillë, sepse sot e kemi një shtet, i kemi institucionet”, thotë Krasniqi për Radion Evropë e Lirë.

Sipas tij, janë institucionet e Kosovës ato që duhet ta orientojnë sot diasporën, për ta shndërruar potencialin e saj në fuqi diplomatike.

Si të vihet diaspora në funksion të diplomacisë?

Para gati dy javësh, Radio Evropa e Lirë i drejtoi Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës pyetje në lidhje me koordinimin e mundshëm midis institucioneve të Kosovës dhe diasporës, si dhe për kontributin e saj të mundshëm në forcimin e pozicionit ndërkombëtar të Kosovës, por, nuk mori përgjigje.

Murtezaj, i cili shërbeu si zëvendësministër i Punëve të Jashtme të Kosovës nga marsi i vitit 2016 deri në qershor të vitit 2017, thotë se një nga sfidat që e ka përcjellë dhe vazhdon ta përcjellë këtë ministri, është mungesa e strategjive të veçanta për çdo vend, marrë parasysh kontekstet e ndryshme në shtetet perëndimore dhe të tjera, ku jetojnë kosovarët ose individë me origjinë nga Kosova.

“Nuk vlejnjë sjelljet dhe objektivat e njëjta për secilin vend. Qeveria e Kosovës duhet të ketë strategji unike, individuale për secilin kontekst shtetëror apo regional nëpër botë”, thotë Murtezaj, duke shprehur bindjen se institucioneve të Kosovës u mungon edhe të kuptuarit e rolit të diplomacisë publike.

“Diplomacia publike shkon përtej komunikimeve zyrtare ‘qeveri me qeveri’ apo ‘ambasadë me ambasadë’. Diplomacia publike prek të gjitha shtresat dhe sferat e jetës në një vend përkatës”, thotë Murtezaj.

Sipas tij, ajo duhet të ketë qëllim edhe krijimin e një terreni për realizimin e ambicieve diplomatike mes autoriteteve të dy shteteve, përmes rritjes së vetëdijes, ndërgjegjësimit dhe më pas edhe njohjes ndërkombëtare të një shteti.

Në këtë lloj diplomacie, thotë Murtezaj, duhet të përfshihen individë nga Kosova që paraqesin histori sukseesi dhe që ndihmojnë në relaksim dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore, kulturore, akademike, institucionale, sportive dhe të tjera.

“Për t'i nxjerrë përfitimet nga kjo minierë potenciale e kontributit për Kosovën, duhet një strategji ombrellë, e cila pastaj ka mundësi t'i orientojë këto kontribute në synime të caktu-

ara”, thekson ai.

Kosova, aktualisht, nuk ka të angazhuar asnjë kompani lobimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Posterë si ky me mbishkrimin “Make Kosovo Great Again” dhe portretet e presidentit të zgjedhur të SHBA-së, Donald Trump dhe Richard Grenell, ishin vendosur gjithandej nëpër Prishtinë, Kosovë, pasi Trump doli fitues në zgjedhjet e nëntorit në SHBA.

Sipas tij, forcimi i imazhit të Kosovës është i domosdoshëm, në kohën kur raportet Kosovë-SHBA janë lëkundur, si pasojë e disa veprimeve të Qeverisë së Kosovës në pjesën veriore të vendit, të cilat SHBA-ja i ka konsideruar si të pakoordinuara dhe me ndikim jo të mirë te komuniteti serb lokal.

“Mendoj se mund të bëhet më shumë. Të kërkojmë forma të reja organizimi dhe që diaspora të mos jetë e shpërqendruar. Iniciativat duhet të nisin nga diplomacia jonë”, thekson Spahiu.

Për Krasniqin, nga organizata Germin, angazhimi i diasporës në çështjet diplomatike është paksa edhe delikat, sidomos kur bëhet fjalë për kontraktimin e kompanive lobuese ose individëve për këtë çështje.


Ai sqaron se shumë individë nga diaspora janë shtetas të vendeve ku jetojnë dhe thotë se kjo do të krijonte një situatë të ndjeshme nëse ata do të angazhoheshin për një shtet tjetër – në këtë rast Kosovën.

Një ide, Krasniqi thotë se mund të jetë krijimi i një departamenti të institucionalizuar, që do të merrej vazhdimisht me çështjet e diasporës dhe angazhimin e saj diplomatik.

Radio Evropa e Lirë bëri përpjekje t'i kontaktojë disa shoqata të kosovarëve në diasporë, si në Evropë, ashtu edhe në SHBA, për të marrë komentet e tyre për qasjen e institucioneve të Kosovës ndaj angazhimit të diasporës në çështje diplomatike. Por, deri në publikimin e këtij artikulli, ato nuk u përgjigjën.

Qytetarët e Kosovës, prej kohësh, pranojnë mbi 1 miliard euro remitencë në vit.

Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës tregojnë, po ashtu, se diaspora zë vendin e parë sa u përket investimeve të huaja në Kosovë, të cilat bëhen kryesisht në patundshmëri./REL



**NESE JU DUHET NJE DOKTOR
MOS HEZITONI TE VIZITONI
VAL CLINIC**

THE BEST MEDICAL CENTER

OUR SERVICES:

CARDIOLOGY

ENT

PAEDIATRICS

GYNAECOLOGY

DERMATOLOGY

INTERNAL MEDICINE

RADIOLOGY

PHYSIOTHERAPY

NEUROLOGY

SURGERY AND MINOR INJURY

UROLOGY

ENDOCRINOLOGY

GASTROENTEROLOGY

AESTHETIC MEDICINE

PODIATRY

FULL CHECK-UP

PSYCHOLOGY

PSYCHIATRY

DIAGNOSTICS:

ALL TYPE OF BLOOD TEST

AND SWABS AFTER

DOCTORS

CONSULTATION



**Pershendetje,
Dr. Arjola KURTI
dhe Dr.Val punojnë
në VAL Clinic që është një
klinikë në Londër me mjek/e
specialistë të gjithë
sherbimeve mjekesore.
Për çdo problem
na kontaktoni**

NA KONTAKTONI



INFO@VALCLINIC.CO.UK

WWW.VALCLINIC.CO.UK

**39 Frederick Road
Rainham RM13 8NJ**

Tel: 01708701155

Mob: 07307595437

ANDI BUSHATI

Socialistët thyen çdo kod politik duke e hapur fushatën e tyre elektorale sikur të qe nisja e një festivali folklorik kombëtar.

Në manifestimin ku u ndërthurën tallavaja dhe folku, ndërmjet Belinda Ballukut që kërcente nën ritemet e “fierakes me fustan me xixa” dhe Hulusi Manjës që i uli njerëzit e tij këmbëkryq përballë një lahutari, u vunë re disa simbole që kërkojnë shpjegim.

E para, askush nga drejtuesit e qarqeve nuk bëri një bilanc të katëvjeçarit, por u mjaftua vetëm me vënien e një basti për të ardhmen. Asnjëri prej tyre nuk e përmendi Partinë Socialiste, por vetëm Edi Ramën.

Çudia ishte se në sheshin Skënderbej nuk shihej gjëkund, ndonjë flamur i PS-së që organizonte tubimin, por valviteshin vetëm ai kombëtar dhe ai i BE-së.

Kjo atmosferë nuk arsyetohet thjeshtë vetëm me lartësimin e kultit të individit që tashmë ka hedhur rrënjë, në një parti ku të gjithë ëndërojnë të kenë karrierën e Mamicës, duke i thurur lavde gojore Skënderbeut.

Fabula ka mundësi të jetë pak më e ndryshme. Ngjan se tendenca është në lartësimin e Ramës dhe në lënien në hije të PS. Dikush me siguri duhet të mbajë përgjegjësi, për Kokën, Ahmetajn, Bllakon, Beqen, Dakon, Gjicin e së fundi Veliajn, që kanë qenë bij të partisë po që ia “kanë punuar pas shpine” liderit të saj. Prandaj në këtë fushatë e para po qëndron pas kuintave, ndërsa Rama do të pushtojë të gjithë skenën.



Më të qarta dhe më konkrete gjurmët e kësaj strategjie, që synon të fshehtë korrupsionin galopant, të anashkalojë dhënien e llogarisë për gjërat e pabëra, të harrojë premtimet e pambajtura – që nga ato për reduktimin e pabarazisë, buxhetin e arsimit, shtimin e vendeve të punës, shëndetësinë falas etj., u panë në fjalimin e Edi Ramës. As ai nuk e përmendi një herë të vetme emrin e Partisë Socialiste.

Kur ndryshe nga të tjerët, kryeministri u ngjiti i vetëm në podium, në paradën e tij verbale u vu re një përpjekje për shkallimimin e kohës dhe përcudnimin e kalendarit. Gjatë monologut ajo që mungonte

ishte e tashmja dhe 12 vitet që ai ka qeverisur.

Për të mbuluar këtë hendek Rama zbriti deri në mesjetën e hershme, rrëmoi në kujtimet murgjive që kishin udhëtuuar në Shqipëri dhe shekujve XI-XII, u afrua deri tek Skënderbeu dhe Gjergj Fishta, për t’u hedhur menjëherë më pas, tek pasaporta e BE-së dhe tek Shqipëria 2030. Lidhja artificiale e këtij kapërcimi ishte se vetëm përmes

“Atij” shqiptarët mund ta bëjnë realitet vokacionin evropian të të parëve.

Por thelbi i këtij manipulimi qëndronte tek ankthi për t’u përballur me të tashmen dhe me faktin e të qenit njeriu me më shumë vite pushtet i

periudhës post komuniste.

Pikërisht për këtë arsye qeveria ka vendosur të kthejë në refren të fushatës pasaportën Evropiane dhe slogonin propagandistik se ajo arrihet “vetëm me Edin”.

Edhe Rama edhe ata që ka përreth e dinë mirë që në një garë elektorale, nuk premtohet dot ajo që shkon përtej një mandati katër vjeçar.

Ata janë të ndërgjegjshëm se Shqipëria nuk ka asnjë shanc real të bëhet anëtare e BE brenda këtyre afatëve apo që qytetarët e saj të kenë në duar një pasaportë të barazvlefshme me atë të francezëve, gjermanëve apo italianëve.

Por kjo është e vetmja mënyrë që ata kanë gjetur për t’u arratisur nga e tashmja, nga hajdutëria dhe dështimet e njëpasnjëshme.

Pikërisht për të shmangur këtë, Edi Rama u detyrua të zbresë dhjetë shekuj në kohë për tu katapultuar menjëherë në dekadën e ardhshme. Kjo shpjegon dhe arsyen se përse hapja e stome e fushatës mund të ngjante me gjithçka, përveçse me një manifestim elektorale.

Njësoj si me ritmet folklorike, po ashtu edhe me tendencën për të prishur rrjedhën historike, qëllimi ishte i njëjtë: shmangia e llogaridhënies për 12 vite qeverisje.

DY KRYEMINISTRA, DY BOTË

Në një botë ku adoleshentët përballen me presione, bullizëm digjital dhe stuhi të përditshme dhune online, reagimi i liderëve bën dallimin mes edukimit dhe propagandës, mes bindjes dhe imponimit, mes frymëzimit dhe frikësimit.

Në Britani, Kryeministri Keir Starmer zgjedh të flasë si prind. Me një postim të thjeshtë por domethënës, ai ndan përvojën e tij personale duke parë një dokumentar me dy fëmijët e tij, “Adolescence”. Starmer theksoi se mbështet vendimin e Netflix për ta shfaqur këtë serial falas në shkolla. Jo për të imponuar moralin e radhës, por për të nxitur bisedat, për të shoqëruar rritjen, për të kuptuar dhe mbështetur brezin e ri në sfidat e tyre reale.

Ndërkohë në Shqipëri, Kryeministri ynë vendos të ndalojë TikTok-un. Jo përmes debatit publik, jo me fakte, jo me transparencë, por me një vendim shoqëruar edhe me një “këshillë” paternaliste:

“Mos përdorni VPN, se ju vjedhin të dhënat.”

 **Keir Starmer** · Follow
23h · 🌐

As a father, watching Adolescence with my teenage son and daughter hit home hard.

We all need to be having these conversations more.

I've backed Netflix's plan to show the series for free in schools across the country, so as many young people as possible can see it.

👍 🗨️ 📄 14K 6.4K comments 576 shares

👍 Like 🗨️ Comment 📄 Send 📄 Share

Tashme kjo lutje po bëhet refren, por refreni i një këngë të lodhur që pak duan ta dëgjojnë.

Sepse këtu, ai nuk flet si prind, as si edukator, por si polic i mendimit, duke shpallur një luftë të kotë me

teknologjinë, ndërkohë që nuk zgjidh asnjë nga problemet reale që lidhen me sigurinë digjitale.

Në vend që të udhëheqë me shembull, e mbulon me censurë.

Në vend që të nxisë debatin, fut kokën

Adhamudh-i i Andon Zako Çajupit.

Se ndalimi i një aplikacioni nuk zgjidh asgjë, nëse nuk merresh me arsyet që çojnë të rinjtë drejt tij: izolimi social, mungesa e ambienteve të argëtimit, mungesa e informacioneve/lajmeve të verifikuara dhe dëshira për

në rërë si struci.

Në vend që të edukojë të rinjtë, i trajton si kalamaj që nuk kuptojnë.

Në vend që të përballojë të vërtetën, i ikën asaj si një aktor i lodhur në një shfaqje ku s’ka më spektatorë. Dhe harron...

Se vetë ka qenë i ri.

Se molla e ndaluar shijon më tepër.

Se jemi në vitin 2025, jo te Doktor

Adhamudh-i i Andon Zako Çajupit. Se ndalimi i një aplikacioni nuk zgjidh asgjë, nëse nuk merresh me arsyet që çojnë të rinjtë drejt tij: izolimi social, mungesa e ambienteve të argëtimit, mungesa e informacioneve/lajmeve të verifikuara dhe dëshira për

të krijuar e shprehur lirshëm.

Dhe kur flet për “sigurinë e të dhënave”...

A është i njëjti Kryeministër që ende nuk ka mbajtur përgjegjësi për rrjedhjen e të dhënave personale në duart e hakerave iranianë?

A e di ai që vetë shteti mbledh, përpunon dhe mund të përgjojë çdo klikim përmes DPI (Deep Packet Inspection)?

Po, siguria digjitale është e rëndësishme. Por censura nuk është siguri. Frikësimi nuk është edukim. Mbyllja e gojës nuk është zgjidhje.

Ndërkohë, në Britani...

Një Kryeministër pranon se edhe ai ka nevojë të mësojë nga fëmijët e tij. Ulet pranë tyre, sheh një dokumentar dhe e përdor atë si pikënisje për një diskutim publik. Jo për të shitur moral, por për të ngritur vetëdije.

Ka një dallim mes liderit që flet me qytetarët dhe atij që u flet qytetarëve
Lutfi Dervishi

FOR SALE

PER SHITJE

**Restorant per shitje ne Londer
I hapur prej vitesh me klientele te
garantuar
I pajisur me te gjitha liçensat
Ambient fantastik per te gjitha llojet e
festestave tuaja mbremje, ditelindje,
fejesa, martesë deri ne 230 veta
Çmimi shumë i arsyeshëm
Për më shumë info ju lutem na
kontaktoni Tel: 07414 828424**



07414 828424

BBC

“Mafia shqiptare më telefononte dhe më thoshte: ‘Duam të dërgojmë 500 kg drogë’, nëse nuk pranon, ata të vrasin.”

César (jo emri i tij i vërtetë) është anëtar i bandës kriminale të drogës Latin Kings në Ekuador. Ai u rekrutua nga një oficer i korruptuar i policisë kundër narkotikëve për të punuar për mafian shqiptare – një nga rrjetet më të fuqishme të trafikut të kokainës në Evropë.

Mafia shqiptare ka zgjeruar praninë e saj në Ekuador vitet e fundit, e tërhequr nga rrugët kyçe të trafikut nëpër vend, dhe aktualisht kontrollon pjesën më të madhe të rrjedhës së kokainës nga Amerika e Jugut drejt Evropës.

Edhe pse Ekuadori nuk e prodhon vetë drogën, 70% e kokainës në botë kalon nëpër portet e tij, sipas presidentit ekuadorian Daniel Noboa.

Ajo kontrabandohet në vend nga Kolumbia dhe Peruja fqinje – dy prodhuesit më të mëdhenj të kokainës në botë. Policia thotë se konfiskoi një sasi rekord të drogës vitin e kaluar, kryesisht kokainë, dhe se kjo tregon se eksportet totale janë në rritje.

Pasojat janë vdekjeprurëse: Janari i vitit 2025 regjistroi 781 vrasje në Ekuador, duke e bërë muajin më të përgjakshëm në vitet e fundit. Shumë prej tyre kishin lidhje me tregtinë ilegale të drogës.

Ne folëm me njerëz përgjatë gjithë zinxhirit të furnizimit për të kuptuar se pse kjo krizë po përkeqësohet – dhe si rritja e konsumit të kokainës në Evropë po e ushqen atë.

César, 36 vjeç, filloi të punonte me kartelat që kur ishte 14 vjeç. Shkak për këtë, ai përmend mungesën e një mundëse për punë.

“Shqiptarët kishin nevojë për dikë që të zgjidhte problemet,” shpjegon ai.

“Unë i njihja rojet e portit, shoferët e transportit, ata që survejonin kamerat e sigurisë.” Ai i korrupton këta persona për ta ndihmuar të kontrabandojë drogë në portet e Ekuadorit ose për të mbyllur sytë – apo edhe ndonjë kamerë.

Pasi kokaina arrin në Ekuador nga Kolumbia apo Peruja, ajo ruhet në magazina derisa punëdhënësit e tij shqiptarë të mësojnë për ndonjë kontejner që do të nisët për në Evropë.

Bandat përdorin tre metoda kryesore për të futur kokainën në dërgesa: 1) e fshehin në mallra para se të arrijnë në port, 2) e fusin në kontejnerë që janë brenda portit, ose 3) e ngjisin drogën në anije ndërsa janë në det.

César ndonjëherë ka fituar deri në 3,000 dollarë për një punë, por nxitja nuk është vetëm paraja: “Nëse nuk e bën një punë që të kërkojnë shqiptarët, të vrasin.”

Ai thotë se ndien një farë pendese për rolin e tij në tregtinë e drogës, sidomos për ata që ai i quan “viktima kolaterale”.

Por ai beson se faji i përket vendeve konsumatore. “Nëse konsumimi vazhdon të rritet, do të rritet edhe



trafikut. Do të bëhet i pandalshëm,” thotë ai, duke shtuar: “Vetëm nëse e luftojnë atje, do të mbarojë këtu.” Punëtorë të zakonshëm, jo vetëm anëtarët e bandave, përfshihen në këtë zinxhir.

Juan (jo emri i tij i vërtetë) është shofer kamioni. Një ditë ai mori një ngarkesë me peshk ton për ta dërguar në port. Ai thotë se rrugës kuptoi se diçka nuk shkante.

“Sinjalin e parë e mora kur arrita në magazinë. Aty ishte vetëm ngarkesa, asgjë tjetër. Ishte një magazinë me qira, pa emër kompanie,” kujton ai.

“Dy muaj më vonë, pashë në lajme që kontejnerët ishin sekuestruar në Amsterdam, plot me drogë. Ne nuk dinim asgjë.”

Disa shoferë transportojnë drogë pa e ditur; të tjerë detyrohen – nëse refuzojnë, i vrasin.

Banda evropiane tërhiqen nga Ekuadori për shkak të vendndodhjes gjeografike, por edhe për shkak të sasisë së madhe të mallrave që eksportohen në mënyrë të ligjshme dhe që ofrojnë një mënyrë të përshtatshme për të fshehur drogën.

“Eksportet e bananeve përbëjnë 66% të kontejnerëve që largohen nga Ekuadori, 29.81% shkojnë drejt Bashkimit Evropian, ku konsumi i drogës po rritet,” shpjegon përfaqësuesi i industrisë së bananeve José Antonio Hidalgo.

Disa banda kanë krijuar edhe kompani fiktive eksport-importi frutash në Evropë dhe Ekuador si mbulesë për aktivitetet e tyre kriminale.

“Këta trafikantë evropianë shtiren si biznesmenë,” thotë “José” (nuk është emri i tij i vërtetë), një prokuror që lufton kundër grupeve të krimit të organizuar dhe që foli në mënyrë anonime për shkak të kërcënimeve që ka marrë.

Një shembull famëkeq është Dritan Gjika, i akuzuar si një nga liderët më

të fuqishëm të mafias shqiptare në Ekuador.

Prokurorët thonë se ai kishte aksione në kompani eksporti frutash në Ekuador dhe kompani importi në Evropë, të cilat i përdorte për trafik kokaine. Ai është ende në arrati, por shumë prej bashkëpunëtorëve të tij janë dënuar pas një operacioni ndërkombëtar policor.

Avokatja Monica Luzárraga mbrojti një nga të pandehurit e Gjyqës dhe tani flet hapur për mënyrën si funksionojnë këto rrjete.

“Në ato vite, eksportet e bananeve drejt Shqipërisë shpërthyen,” thotë ajo. Ajo duket e zhgënjyer që autoritetet nuk e kuptuan më herët se grupet kriminale po i përdornin këto si mbulesë: “E gjithë ekonomia këtu është në ngërç. Por një kategori që ka rritje në eksport janë bananet. Pra, dy plus dy bëjnë katër.”

Pse po rriten eksportet Në portet e Ekuadorit, policia dhe ushtria përpunon të kontrollojnë situatën.

Varka patrollojnë ujërat përreth, policia skanon kutitë e bananeve për “bukë” me kokainë – madje edhe policë polumbarë kërkojnë drogë të fshehur nën anije.

Të gjithë janë të armatosur rëndë, edhe ata që thjesht ruajnë kutitë e bananeve para se të ngarkohen nëpër kontenierë. Kjo sepse nëse gjendet drogë gjatë një kontrolli, ndonjë punonjës portit i korruptuar mund të jetë i përfshirë – dhe kjo mund të çojë në një incident të dhunshëm.

Megjithë këto përpjekje, policia thotë se sasia e kokainës që kontrabandohet me sukses nga Ekuadori ka arritur nivele rekord. Faji i hidhet kërkesës në rritje dhe faktorëve ekonomikë.

Rreth 300 ton drogë u sekuestruan vitin e kaluar – një rekord vjetor i ri, sipas ministrisë së brendshme të Ekuadorit.

Major Christian Cozar Cueva nga Policia Kombëtare thotë se “ka pasur rreth 30% rritje të sekuestrimeve që ishin të destinuara për Evropë vitet e fundit”.

Kjo rritje e dërgesave të kokainës e ka bërë më të rrezikshme për ata që përfshihen në zinxhir.

Shoferi i kamionit “Juan” thotë se rritja e “kontaminimit të kontejnerëve” e bën atë më të ekspozuar. Ai thotë se zyrtarët sekuestruan një kontejner një ditë më parë me dy ton drogë: “Më parë flisnim për kilogramë, tani flasim për ton.”

“Nëse nuk pranon që droga të futet në kontejner, ke dy mundësi: ta lësh punën ose të përfundosh i vdekur.”

Një ekonomi e goditur nga pandemia e Covid-it i la më shumë ekuadorianë të ekspozuar ndaj rekrutimit nga bandat.

Një shtet i dobësuar financiarisht pas pandemisë, një forcë sigurie pa përvojë me krimin e organizuar dhe rregulla të dobëta vizash, i dhanë mundësi grupeve evropiane të vendoseshin aty pas vitit 2020.

Monica Luzárraga thotë se viti 2021 ishte momenti kur “nisi infiltrimi i mafias shqiptare”.

Ajo thotë se kjo periudhë përkoj me një “fluks” të shtetasve shqiptarë dhe një rritje të eksporteve të bananeve, përfshirë drejt Shqipërisë.

“Kjo është një ekonomi fitimprurëse që dëmton Ekuadorin dhe pasuron organizatat kriminale. Si mund të pranojmë një ekonomi të ndërtuar mbi vuajtje?”

Një mesazh për Evropën

Kjo zemëratë ndaj karteleve të huaja është e kuptueshme, duke parë ndikimin e tyre në rritjen e dhunës.

Por një gjë ku bien dakord trafikantët dhe ata që i luftojnë: tregtia ushqehet nga konsumatorët, veçanërisht në Evropë, SHBA dhe Australi.

Të dhënat e OKB-së tregojnë se konsumimi global i kokainës ka arritur nivele rekord. Sondazhet tregojnë se Britania ka përqindjen e dytë më të lartë të përdorimit të kokainës në botë.

Agjencia Kombëtare kundër Krimit në Britani (NCA) vlerëson se vendi konsumon rreth 117 ton kokainë në vit dhe ka tregun më të madh në Evropë.

Të dhënat tregojnë se konsumimi në Britani është në rritje.

Analizat nga Ministria e Brendshme britanike tregojnë se konsumimi i kokainës u rrit me 7% nga viti 2023 në 2024. NCA konfiskoi rreth 232 ton kokainë në 2024, krahasuar me 194

ton në 2023.

Zëvendësudrejtori i NCA-së për krimin e organizuar, Charles Yates, thotë se Britania është “vendi i preferuar” për grupet kriminale që përfitojnë nga kërkesa e lartë.

Ai vlerëson se tregu i kokainës në Britani ka vlerën rreth 11 miliardë £ (14.2 miliardë dollarë), dhe bandat fitojnë rreth 4 miliardë në vit vetëm në këtë vend.

Ata që luftojnë këto grupe në Ekuador, si prokurori José, thonë se është detyrë e “vendeve të konsumatorëve të ushtrojnë më shumë kontroll” mbi ata që e financojnë tregtinë. Viktimat e këtij trafiku janë të shumëllojshme.

Për z. Hidalgo janë biznesmenët që eksportojnë banane, që pësojnë dëme ekonomike dhe në reputacionin e tyre. Për znj. Luzárraga, janë “fëmijët, adoleshentët që po rekrutohen nga bandat kriminale”.

“Në Evropë ka qytetarë të gatshëm të paguajnë shumë para për drogën që konsumojnë. Droga që në fund po i kushton jetën qytetarëve ekuadorianë.”

NCA thekson se përveç këtyre efekteve “katastrofike” për komunitetet përgjatë zinxhirit të furnizimit, përdorimi i kokainës po shkakton edhe viktima në vetë përdoruesit, për shkak të ndikimeve kardiovaskulare dhe psikologjike. Vdekjet nga kokaina në Britani u rritën me 30% në vitin 2023 krahasuar me 2022, duke arritur në 1,118 raste.

NCA gjithashtu paralajmëron se droga ndikon në përkeqësimin e dhunës në familje.

Ata janë të qartë se përpjekjet për të frenuar furnizimin nuk mjaftojnë: “Veprimet në anën e furnizimit nuk do të jenë kurrë zgjidhja e vetme. Ajo që ka rëndësi është ndryshimi i kërkesës.”

Nga anëtarët e bandave të drogës deri te vetë presidenti i vendit – ky është mesazhi i Ekuadorit për Evropën.

Presidenti Daniel Noboa, i cili kandidon për një mandat të dytë në zgjedhjet presidenciale të 13 prillit, e ka bërë luftën kundër bandave kriminale një nga prioritetet e tij dhe ka vendosur ushtrinë për të luftuar dhunën.

Ai i tha BBC-së: “Zinxhiri që përfundon me ‘argëtimin e britanikëve’ përfshin shumë dhunë.”

“Çfarë është argëtim për një person, ndoshta përfshin 20 vrasje gjatë rrugës.”/ Nga Ione Wells, korrespondent i Amerikës së Jugut për BBC

ZYRA ME QERA

FOR RENT Offices

Zyra me qera në Chelmsford Essex
Me madhësi të ndryshme me parking
Të përshtatshme për llogaritarë,
avokat apo për kompani të
ndryshme.

Çmimi shumë i arsyeshëm
Për më shumë info
ju lutem na kontaktoni

07909620140

Call Us Now!



1939/ “ÇFARË THOTË GERALDINA?”, INTERVISTA ME MBRETËRESHËN E SHQIPËRISË NË LETONI

AURENC BEBJA

Gazeta letoneze “Brīvā Zeme” ka botuar, të shtunën e 15 korrikut 1939, intervistën ekskluzive asokohe me mbretëreshën Geraldinë në Letoni, të cilën, Aurenc Bebjja, nëpërmjet Blogut “Dars (Klos), Mat – Albania”, e ka sjellë për publikun shqiptar :

Çfarë thotë Geraldina ?

Dje, në dhomat e pritjes së hotel “Petersburg” pranë dhomave të ish-mbretit të Shqipërisë funksiononte një qendër vëzhgimi gazetareske.

U mblodhën jo vetëm përfaqësues të gazetave të Rīgës, por edhe tre gazetarë erdhën nga Suedia. Ata punonin me ritmin amerikan dhe telefononin çdo orë në Stokholm për t’i informuar për ndryshimet dhe ngjarjet në “Petersburg”.

U përhap lajmi se Aleksandri i vogël do të bënte një banjë. Ndërmarrja e suedezëve u dyfishua dhe me mjetet më të pazakonta ata u përpoqën të kalonin me nxitim murin e trashë mbrojtës në dhomën ku princi i vogël ishte vendosur në banjë.

Atëherë lexuesit suedezë do të mermin kafshatën më të shijshme në mbrëmje : Geraldinën dhe Aleksandrin në banjë! Fatqeqësisht, përpjekjet e suedezëve ishin të kota. Rojet ishin të pamposhtur.

Më pas, për habinë e madhe të të gjithëve, pa asnjë takim, ish-Mbreti Zog u shfaq në shkallët e hotelit me Geraldinën dhe motrat e tij. Ata shkuan në një udhëtim në Kemer dhe me siguri do të qëndrojnë në Riga deri të hënën.

Kontribuesi ynë foli dje me ish-Mbretëreshën Geraldinë të Shqipërisë.



Rojet qëndrojnë roje jashtë dhomave të Zogëve me fytyra të palëvizshme. Heshjtja mbretërore kudo. Pas perdeve të rënda të kuqe të errëta, dera e madhe u hap dhe Shqipëria ishte atje.

Ministri i Oborrit Martini më ftoi në apartamentet mbretërore me një tundje të lehtë të dorës.

Në mes të sallës së madhe, Geraldina buzëqeshi. Dukej kaq e hollë, e brishtë dhe feminare.



“Për shumë vite kisha dëgjuar për Letoninë mikpritëse dhe për peizazhet e saj piktoreske natyrore. Prandaj, zgjodha me shumë kënaqësi udhëtimin nëpër Riga. Edhe pse nuk kam parë ende shumë sot, jam akoma e emocionuar për gjithçka që kam parë. Shpresoj të njoh më mirë natyrën dhe njerëzit e saj në pak ditë që do të kaloj në Letoni.”

Më tej ajo shprehu shpresën e saj për të qëndruar në Riga të paktën deri të hënën, për të udhëtuar në fshat, buzë detit dhe për të parë pamjet më të spikatura të kryeqytetit tonë. Më pas ata do të shkojnë në Suedi.

Pastaj Geraldina më tha se gjyshja e saj ishte martuar me një suedez dhe jetonte në Suedi për një kohë të gjatë.

Prandaj, ajo do të ishte e lumtur të shihte sërish vendet ku dikur ecnin paraardhësit e saj. Në kohën e lirë ajo kalon shumë kohë duke luajtur muzikë dhe, së bashku me Zogun, duke lexuar veprat e shkrimtarëve më të shquar evropianë, si në original ashtu edhe në përkthim. Përpara se të takohej me Zogun, ajo nuk fliste shqip, por pas disa muajsh punë të palodhur, “plasarit” deri në atë pikë sa tani mund ta flasë lirshëm me bashkëshortin.

Ka kaluar një çerek ore. Ministri i oborrit njofton se ka ardhur koha që Geraldina të shkojë për drekë. Me një shtërngim duarsh të ngrohtë, ajo jep lamtumirën dhe zhduket në apartamentin tjetër me hapa të lehtë dhe të zhdërvjellët.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946

Akoma nuk keni një website?

The Albanian

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

 **020 7018 7929**

 **073 4066 5946**  **078 5997 7545**

MAL BERISHA

Në një atmosferë solemniteti dhe mjedis të veçantë artistik, salla e Universitetit të Arteve në Tiranë u shndërrua në një tempull të artit lirik, në pritje të një ngjarje të veçantë kulturore: Premierën e operës “Rozafa”. Nga nota e parë deri në të fundit, vepra përcolli ngarkesë të thellë emocionale dhe forcë dramatike.

E kompozuar nga David Tukiçi, bazuar në libretin e të ndjerit Fadil Kraja, e shoqëruar me mjeshtëri nga Orkestra e Harqeve të Radio Televizionit Shqiptar nën drejtimin e saktë dhe profesional të dirigjentit Olsi Qinami, ajo e mbajti audiencën “pa frymë” në tërë zhvillimin e saj dramatik, muzikor dhe skenik.

Në një kohë kur arti i vërtetë, ai që përcjell mesazhe të qarta edukative, që pasqyron thelbin e identitetit dhe të qenies sonë kombëtare, po zëvendësohet gjithnjë e më shumë nga forma të zbrazëta të një snobizmi të ashtuquajtur modern, shfaqja e një veprë të tillë si “Rozafa” vjen si një dritë e rrallë në horizontin e kulturës sonë. Dhe këtë dritë e sollti një emër që s’ka nevojë për prezantim: David Tukiçi, kompozitor, dirigjent, këngëtar, yll i skenës shqiptare që në fëmijëri dhe mbi të gjitha bir i një familjeje artistësh të mirënjohur.

David Tukiçi, i biri i të paharruarit Ibrahim Tukiçi, dhe vëllai i artistit të njohur Genc Tukiçi, mishëron

vazhdimësinë e një trashëgimie të pasur që i ka dhënë artit shqiptar disa nga faqet e tij më të ndritura. E megjithatë, për të folur për veprën dhe jetën e kësaj familjeje të shquar, do të duhej një kapitull më vete. Por sot, le të ndalemi pikërisht këtu – te “Rozafa” – një premierë që ngre lart jo vetëm artin muzikor shqiptar, por vetë frymën tonë kombëtare.

Kjo veprë nuk është thjesht një rrëfim i përcjellë me mjeshtëri në formë muzikore. Është një psherëtimë shekullore që merr formë, zë dhe dritë në skenë.

Ajo rikthen përpara syve tanë figurën tronditëse dhe të pavdekshme të Rozafës, gruas që pranon të murosset për të bërë të mundur ngritjen e qytetit, ku është edhe sot kalaja me të njëjtin emër, si dhe qëndrueshmërinë e popullit shqiptar. Ajo është unike në llojin e vet të legjendave, jo vetëm te ne shqiptarët, por ndoshta në tërë botën.

Teksti i Fadil Krajës nuk është vetëm një përshtatje e legjendës, por një lirisim dramatik i thellë, poetiko-tragjik, që vjen nga thellësia e trojeve tona ilirike, arbërore, shqiptare. Rozafa, në këtë operë, nuk është një martire e heshtur; ajo flet, mendon, dashuron dhe sakrifikon me një ndërgjegje që i kapërcen kufijtë e një legjende popullore. Fjalët e saj nuk janë fjalë lamtumire, por fjalë jete: Të rrojë fëmija, të lulëzojë familja, të

KOMPOZITORI DAVID TUKIÇI I JEP JETË LEGJENDËS SHQIPTARE NË PREMIERËN E OPERËS “ROZAFÄ”



qëndrojnë qyteti.

David Tukiçi, me gjuhën e tij muzikore të përpunuar dhe të rrënjosur thellë në traditën shqiptare, i jep veprës një frymë të re, të drithërueshme e sublimë. Tingujt e saj, që shpesh të kujtojnë legjendën në këngët e bukura shkodrane, nuk janë thjesht melodi, por klithma të historisë dhe këngë shpirti. Rozafa këndon me një zë nënash shekullore, ndërsa kori jehon si zëri i një populli që mban mend dhe e nderon atë – dhe vetë historinë e tij.

Dramaticiteti dhe lirika muzikore ndërtojnë dhe shembin, qetësojnë dhe trazojnë, sikurse bëjnë të gjitha veprat e mëdha që mbartin të vërtetën njerëzore në thelb, ashtu siç i kemi parë në veprat madhështore të kompozitorëve

botërorë të kësaj gjinie muzikore.

Në skenë, “Rozafa” shndërrohet në teatër të ndjenjës dhe të simbolit. Muri që ngrihet nuk është vetëm vendosje një mbi një i gurëve, por ndërtim i një identiteti të thellë shqiptar ndër shekuj. Akti i murosjes bëhet akti i rilindjes, e Rozafa, përkundër dhimbjes, ngrihet si figura më e lartë e dashurisë njerëzore. Ajo nuk vdes. Ajo jeton në çdo gur të kalasë, në çdo nënë shqiptare që jep gjithçka për të ardhmen. Ajo jeton edhe sot në Kalanë e Rozafës, në Shkodrën tonë fisnike!

Opera “Rozafa” është më shumë se një ngjarje artistike. Ajo është një testament kulturor, një thirrje për kujtesë dhe një ftesë për bashkim shpirtëror me vlerat më të pastra që kombi ynë

mund të mbajë. Ajo është një dëshmi se arti nuk është zbukurim, por themel qenësie, ashtu siç ishte Rozafa për kalanë, dhe opera me emrin e saj për ne që e pamë mbrëmë në sallën e Universitetit të Arteve.

Interpretimi i artistëve të shquar Ardita Meni në rolin e Rozafës dhe i Josif Gjipalit në rolin e bashkëshortit të saj, Ujkanit; Marjana Lekes në rolin e nënës, i Armando Likës në rolin e plakut të urtë, Bledar Domit si vëllai i dytë, bashkëshorti i Xhixhës, interpretuar nga Greta Zani, dhe i Jurges Tomorrit në rolin e Sokolit, vëllait të madh, së bashku me Tanën, bashkëshorten e tij, të interpretuar nga Suada Gjergji, në atmosferën mbresëlënëse të krijuar nga kori i studentëve të Universitetit të Arteve, nën drejtimin e mjeshtër Bujar Alliu, dhe me shoqërimin e Orkestrës së Harqeve të Radio Televizionit Shqiptar, dirigjuar nga Olsi Qinami, me koncertmaestër Ardita Bufaj, sollti një premierë që do të mbahet mend gjatë nga të gjithë ne që ishim në atë sallë.

Do ta mbyll këtë shkrim të shkurtër, siç mund ta shprehte vetë David Tukiçi: “Në çdo tingull të kësaj opere, në çdo gur të murit që ngrihet, kam dashur të vendos frymën e nënës shqiptare që ushqen jetën edhe nga thellësia e dhimbjes dhe të vetë qenies tonë shqiptare”. Përgëzimet e mia më të ndjera i dashur David!

SALMONELA BRAZILIANE DHE PASAPORTA EUROPIANE

LUTFI DERVISHI

Mishin e servirim me salmonelë, mandarinat i spërkasim me pesticide dhe mbi 50 lloje helmesh të ndaluar në Bashkimin Evropian përdoren lirshëm në bujqësi, por ne vazhdojmë të ëndërrojmë BE-në. Jo si standard, por si pasaportë.

Ëndrra jonë europiane ka erë pesticide. Dhe nuk është ndonjë sekret. Institucione ndërkombe, organizata të shëndetit publik, raportimet e medias dhe të qytetarëve, të gjithë e kanë ngritur alarmin. Por çfarë bëjmë ne? Shtojmë dozën.

Pse? Sepse i fusim një mendje të lehtë: “Hë mo, s’na gjen gjë!”

Një mantrë kolektive, një justifikim i përbashkët për të helmuar tokën, trupin dhe fëmijët tanë.

Pis fermer që përdor helme për të shtuar prodhimin, pis shtet që nuk kontrollon asgjë, pis konsumator që i blen pa pyetur, pa refuzuar dhe pa reaguar. Pra, në fund të ditës: pis millet.

Po të ishte kjo thjesht çështje padije, do kishite zgjidhje. Por është çështje indiference dhe babëzie, e ushqyer me arrogancën e mosndëshkimit. Të mos harrojmë: në vendet ku janë ndaluar

këto pesticide, janë ndaluar sepse vrasin. Dhe në ketu, jo vetëm që përdoren, por promovohen si “sekret suksesi”.

Fondet e IPARD që u dhanë për bujqit dhe blegoret shqiptare mesa duket realisht kanë shkuar për fermerët braziliane. Fondet e BE për bujqësinë janë ndërprerë sepse SPAK nuk ka këllqe të hetojë atë që është provuar nga hetimet në Bruksel. Ne vijojmë me helmin e sheqerosur të propagandës.

Në vend të ndalim helmin, kemi ndaluar logjikën. Në vend të zbatojmë rregulla, bëjmë stative krenare për eksportin e produkteve “të freskëta shqiptare” që pastaj kthehen mbrapsht si mall i rrezikshëm për shëndetin publik.

Tani le të hapim krahët për BE-në. Le t’i tregojmë që jemi gati për integrim. Me mushkëri të skuqura, me veshka të lodhura dhe një sistem që nuk mbron as veten e vet. Edhe 5 vjet dhe marrim pasaportën. Por a do jemi gjallë për ta përdorur?



Kur ngatërrojmë Evropën me BE, dhe samitet me reformat!

Në një akt solemn, qeveria ka shpallur 15 dhe 16 majin ditë pushimi, jo sepse kemi festë kombëtare, as ndonjë vizitë papnore, por sepse në Tiranë do të mbledhet Komuniteti Politik Evropian (KPE). Titull pompoz tash tre vjet, si një pemë që nuk lidh kokrra! Qeveria, me dashurinë e zjarrtë për gjeste teatrale, vendosi të mbyllë zyrat shtetërore në Tiranë, Kamëz, Vorë e Krujë. Përgjashtohen nga

pushimi forcat e rendit, mjekët dhe zjarrfikësit, si me qenë gjendje lufte. Në luftë nuk jemi, por dikush duhet të shpjegojë në çdo cep të qytetit se çfarë është ky Komunitet Politik Evropian (KPE) që po na bllokton rrugët, ekranet e televizioneve dhe... mendjen. Duket një lloj si Plani Balladur i Stabilitetit 30 vjet me parë, që u zvenit pa lënë gjurmë.

KPE?

Ka europianë që e bëjnë këtë pyetje, shumica as që ka dëgjuar për të, ndërsa më të informuarit thonë se është një mekanizëm për të përfshirë vendet e Ballkanit, por pa i futur në BE. Një bebe franceze, një mençuri marramendëse, por në vetvete, bosh! Krejt bosh! Për ata që thonë “Bravo” pa hapur gojën lideri, kjo “Europa” që vjen në Tiranë nuk është as Bashkimi Evropian, as NATO, e as ndonjë aleancë që sjell fonde, as, as, as... Komuniteti Politik Evropian është... një lloj “Eurovizioni pa këngë”, ku liderët bëjnë selfie, flasin për “vlëra dhe sfida të përbashkëta” dhe... mirupafshim në samitin e radhës.

Por atëherë përse gjithë kjo histeri? Sepse jemi në fushatë. Ja, erdhi Europa këtu. Ndërkohë që fjala “samit”

përmendet 35 herë në ditë, harrojmë që kemi 34 kapituj për të mbyllur.

A po vjen vërtet Europa këtu?

Samiti i mëparshëm i KPE-së u mbajt në Moldavi! Atje nuk pati ditë pushimi, nuk u bë Chișinău si “Tirana e blinduar”, dhe askush nuk ndërpreu orët e punës për të parë Ursula von der Leyen duke bërë shëtitje me Maia Sandun. Uau, çfarë fati i lumtur për ne shqiptarët!


KPE nuk jep fonde, nuk hap negociata, nuk vendos standarde. Është një klub që i thotë vetes “politik”, por ka aq efekt praktik sa mund të ketë një postim në Facebook.

Me pak fjalë: Tirana po bën teatër me Evropën! Po gënjejmë veten. Për këtë, nuk na e merr njeri. Publikun evropian, aq më pak zyrtarët, nuk i mashtrojmë dot lehtë. Sepse Evropa, ajo e vërteta, ku mund të na çojë vetëm PS-ja, nuk impresionohet me samite që paralizojnë qytete, por me vende që bëjnë reforma, jo “show”.

Dhe, në këtë klimë globale të paqartësive, fakti që askush nuk e di saktësisht çfarë është Komuniteti Politik Evropian... kjo është gjëja më evropiane që mund të ndodhë.

**FOR
SALE**

**Coffee Shop For SALE NEAR WOOD
GREEN TRAIN STATION**



Coffee Shop PËR SHITJE

Good selling price

I hapur prej vitesh
Me klientele te garantuar
Mundesit fantastike per zhvillimin
e biznesit
Afer stacionit te trenit
ne Wood Green

Contact Us Whatsapp

07702576611



REASONABLE PRICE



REASONABLE PRICE



07702576611

REL

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka propozuar të mërkurën sekretarit të Jashtëm të Mbretërisë së Bashkuar, David Lammy, lidhjen e një marrëveshjeje për mbrojtje dhe për ekonomi ndërmjet dy vendeve.

Lammy po qëndron për vizitë zyrtare në Kosovë, në kuadër të një turneu në Ballkanin Perëndimor, që, sipas Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, ka për qëllim kyç forcimin e bashkëpunimit në luftimin e imigracionit të parregullt dhe krimin të rëndë të organizuar.

Osmani ka thënë, në një konferencë të përbashkët për media me Lammy, se me kryediplomatën britanik ka diskutuar për "thellimin strategjik të bashkëpunimit" ndërmjet Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar, i cili, sipas saj, "në veçanti do të mbulojë fushën e mbrojtjes dhe të ekonomisë".

Presidentja kosovare ka bërë të ditur se ka diskutuar "gjerë e gjatë" me Lammy, i cili ka mirëpritur idenë e një thellimi bashkëpunimi.

Osmani ka thënë se autoritetet e Kosovës janë të përkushtuara për të punuar me ato britanike për t'i dhënë formë marrëveshjes, që ajo të nënshkruhet sa më parë.

Ajo ka bërë, po ashtu, thirrje për prani edhe më aktive të Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë.

Lammy ka thënë se Ballkani është rajon që ka rëndësi për Britaninë sot, ashtu siç kishte kur Tony Blair ishte kryeministër.

Ai ka shtuar se Britania "do të vazhdojë të luajë rolin e mikes dhe partneres kyç" të Kosovës.

Kryediplomati britanik ka thënë se vendi i tij dëshiron një "normalizim të qëndrueshëm e paqësor" ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, teksa ka bërë thirrje që autoritetet e Kosovës të angazhohen me plot energji në dialogun me Serbinë, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Osmani ka thënë se "Kosova mbetet një palë konstruktive, e përkushtuar për paqe dhe stabilitet, pavarësisht se vazhdimisht përballlemi me obstrukcione dhe provokime nga ana e Serbisë, përfshirë edhe sulmet e njëpasnjëshme që kanë filluar vite më herët dhe po vazhdojnë edhe tani, për ç'gjë dua ta përmend sërish se është e domosdoshme që të ketë llogaridhënie dhe vënie të autorëve para përgjegjësisë nga ana e Serbisë".

"Por, fatkeqësisht po e shohim se nuk ka asnjë lëvizje në këtë drejtim, as sa i përket aktit të agresionit të shtatorit 2023, as sa i përket sulmit ndaj 93 ushtarëve të NATO-s, që ka ndodhur edhe më herët, po as edhe veprimeve të fundit terroriste që kanë ndodhur në veri të vendit", është shprehur ajo.

OSMANI I PROPOZON BRITANISË MARRËVESHJE PËR MBROJTJE DHE EKONOMI



Lammy ka thënë se Britania është kontribuuese e rëndësishme në misionin paqeruajtës të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë, KFOR, i cili, sipas tij, është "absolutisht vendimtar" për sigurinë e Kosovës.

Kurti i flet Lammyt për Radoiçiqin
Të martën mbrëma, kryediplomati britanik u prit në Prishtinë nga kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, dhe ministri i Jashtëm të Kosovës, Albin Kurti, dhe ministri i Jashtëm të Kosovës, Albin Kurti, dhe ministri i Jashtëm të Kosovës, Albin Kurti.

Kurti ka biseduar me Lammy, ndër të tjera, rreth situatës aktuale në rajon dhe asaj gjeopolitike në Evropë, si dhe për çështjet e sigurisë, ka bërë të

ditur Zyra e Kryeministrit.

Kreu në detyrë i ekzekutivit kosovar "theksoi faktin që ende nuk ka drejtësi dhe llogaridhënie për sulmin terrorist në Banjskë, teksa Millan Radoiçiq endet i lirë dhe i mbrojtur nga aparati shtetëror serb", thuhet në komunikatën e Kryeministrit.

Në shtator të vitit të kaluar, Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti aktakuzë ndaj 45 personave - në mesin e tyre edhe Millan Radoiçiq - për sulmin e armatosur ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë më 24 shtator të vitit 2023, kur kishte mbetur i vranë rreshteri Afrim Bunjaku.

Autoritetet në Serbi nuk pranojnë ta ekstradojnë Radoiçiqin në Kosovë dhe thonë se ai do të gjykohet nga "gjykatat serbe", ndërsa zyrtarët në Kosovë thonë se ato i kanë ofruar mbrojtje atij.

Kurti ka shtuar se Radoiçiq "duhet të ekstradohet në Kosovë ku do të ballafaqohet me një gjykim të drejtë për veprat e tij".

Më herët, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës ka vlerësuar vizitën e Lammyt në vend, duke thënë se ajo "thekson angazhimin e përbashkët për forcimin e lidhjeve mes dy shteteve dhe avancimin e paqes e stabilitetit në rajon dhe më gjerë".

Homologia kosovare e Lammyt, Donika Gërvalla-Schwarz, e ka informuar sekretarin e Jashtëm britanik për, siç është thënë në një komunikatë të MPJD-së, "sfidat e sigurisë në Ballkan, përfshirë veprimet destabilizuese të Serbisë dhe ndikimin rus, të cilat vazhdojnë të rrezikojnë stabilitetin rajonal".

MPJD është shprehur më tej se "partnëriteti mes Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar do të vazhdojë të forcohet dhe të thellohet, me fokus në përmirësimin e bashkëpunimit në fushat e sigurisë, ekonomisë dhe politikës ndërkombëtare".

I pranishëm në takimin e Lammyt me kabinetin qeverisës të Kosovës mori pjesë edhe ambasadori britanik në Kosovë, Jonathan Hargreaves, i cili ka thënë se miqësia mes Kosovës dhe Britanisë është e kamotshme dhe e fortë.

Sekretari i Jashtëm britanik, pas qëndrimit në Kosovë, pritet ta vizitojë edhe Serbinë, ku është paraparë, sipas Qeverisë britanike, nënshkrimi i një marrëveshjeje të bashkëpunimit për luftimin e bandave në qendër të krizës me imigracionin ilegal dhe për sigurimin e kufijve të Mbretërisë së Bashkuar.

Mbretëria e Bashkuar do të jetë mikpritëse e një takimi të udhëheqësve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të Samitit të Procesit të Berlinit, në Londër, në vjeshtën e sivejetme, i cili, ndër tjerash, ka për qëllim të mbështesë stabilitetin, sigurinë dhe bashkëpunimin ekonomik mes vendeve të rajonit.

VETON SURROI

Skena me panikun rreth tarifave amerikane ndaj Kosovës duhet të zëvendësohet me një analizë të esëllt të botës së re në të cilën po jetojmë. Në vend të porosive në media sociale se sa duhet të jetë tarifa tregtare apo çmimi i energjisë elektrike, nevojitet identifikim i proceseve strategjike përpara

1.

Profesori Fehmi Agani me sensin e tij të hollë të humorit, në momentin kur stjuardesa e avionit shpërndante gazetatat dhe kishte mbetur vetëm “Financial Times”, më lutë ta merrja një ekzemplar për të:

“Më duhet t’i shikoj vlerat e aksioneve të mia në tregjet financiare”.

Më ra në mend profesori këto ditë, pas shpalljes së tarifave importuese ndaj shteteve të botës nga presidenti Trump, se si Kosova dhe shqiptarët (dhe një pjesë e konsiderueshme e botës që nuk merr pjesë në tregun e aksioneve) janë në pozitën vetëdallëse të profesorit Agani, i cili lëre që nuk ishte pronar aksionesh, por nuk kishte parë një me sy ndonjëherë.

Lexojmë për rënien dramatike të vlerës së aksioneve në botë dhe kjo me siguri duhet të jetë diçka që na brengos, por nuk dimë saktësisht pse. Dimë po ashtu për një pikë reference, faktin se reagimi i tregjeve ndërkombëtare ndaj tarifave të presidentit Trump është i njëjtë si kur u shpall pandemia COVID-19 dhe kjo mjafton për të na frikësuar: po ndodh diçka që i përngjet COVID-it, boll vetëm të dëgjohet ky emër dhe e kemi të qartë ngërçin nëpër të cilin kaluam.

2.

Tronditja më të vërtetë është e madhe dhe tregjet financiare janë vetëm indikatorë emocionalë. Paraja është frikacake e madhe dhe ajo nuk del nga xhepi i investitorit në momentin kur ekziston një ndryshim i thellë e i madh me paparashikueshmëri për zhvillimet në të ardhmen. Kjo është pak a shumë çka po ndodh në botë pas vendosjes së tarifave për të gjitha shtetet e botës nga presidenti Trump.

Dhe problemi nuk është se a i është vendosur dikujt një tarifë prej 40 për qind e dikujt tjetër 10 për qind - kjo duket të jetë zbavitja e analistëve që u ngjasojnë atyre të pasndeshjeve futbollistike, por me faktin se SHBA-ja ka vendosur tarifa.

SHBA-ja i ka prirë ekonomisë botërore pas vitit 1945 me konceptin bazik të tregjeve të lira. Me ide dhe energji prijëse amerikane janë ndërtuar Banka Botërore, Fondi Monetar

Ndërkombëtar, Plani Marshall (dhe me të BE-ja dhe tregu i lirë evropian) e deri tek Organizata Botërore e Tregtisë, ku me anëtarësimin e Kinës ndryshuan në mënyrë dramatike edhe Kina e edhe ekonomia botërore. Vendosja e tarifave nga presidenti Trump që mbyllje e një kapitulli jashtëzakonisht të suksesshëm konceptual të politikës amerikane të filluar pas Luftës së Dytë Botërore. Në thelb të kësaj politike ishte vetinteresi amerikan e që dukej i formuluar pak a shumë kështu: ne si ekonomia më e madhe në botë do t’i dominojmë tregjet botërore me produktet tona, por ato produkte duhet që dikush t’i blejë, e për t’i blerë duhet të ketë ekonomi funksionale. Për të pasur ekonomi funksionale u duhet ndihma jonë amerikane me një sistem global të tregtisë së lirë.

Kapitulli i ri, me përcaktimin e vetinteresit amerikan nga presidenti Trump, fillon pak a shumë kështu: të gjithë të tjerët janë pasuruar në kurriz të Projektit amerikan të tregtisë së lirë dhe ne do ta ndalim këtë projekt me tarifa importi.

3.

Në Kosovë u reaguua me emocion, sikur të bëhej fjalë për njërin prej eksportuesve më të mëdhenj në tregjet amerikane. Për dikë që shikon nga jashtë dhe që i kupton shifrat do të dukej jo fort e kuptueshme; eksportet në Amerikë nuk kanë ndonjë peshë dhe fundja, tarifa ndëshkuese është

më e ulët se për shumë të tjera dhe për më tepër, atë në fund do ta paguajë konsumatori amerikan. Për shumë shtete, këto do të duken si tarifa ndëshkuese, por në kuptimin e thjeshtësuar ekonomik janë taksa të rritura për konsumatorin amerikan. Televizori kinez që ka kushtuar 300 dollarë, do të kushtojë 420, kurse atletet e firmave të njohura sportive të prodhuara në Vietnam do të kushtojnë për aq sa është vendosur tarifa. Dallimin në çmim do ta paguajë konsumatori amerikan.

Por, problemi i reagimit emocional kosovar nuk ka të bëjë vetëm me sensin e panikut. Brenda një pasdite pati në media sociale këmbime urgjente porosish të bartësve të institucioneve publike për nevojën e anulimit të tarifave. Edhe kjo duket nuk që gjë e re, ngase ky këmbim pasoi pas disa këmbimesh të mëhershme lidhur me çmimin e energjisë elektrike, diçka që nuk i përket asnjërit prej institucioneve të prononcuara; të njëjtën kompetencë për caktimin e çmimit të energjisë elektrike do ta kishin edhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe Shoqata e Shkrimtarëve e Kosovës.

Reagimi kosovar - një pjesë e të cilit është pjesë e ndërkamcave politike - në shumicën e vet të madhe nuk ka të bëjë fare me tarifën dhe pasojat për tregtinë me Amerikën. Në shumicën e vet të madhe reagimi nuk bëhet për çështje eksporti - pra të mallrave - por për çështje importi, të sigurisë e përkrahjes politike.

Mendja kolektive kosovare - e ndërtuar prej përcaktimit strategjik në lidhje me Amerikën gjatë rezistencës së padhunshme që nga viti 1989 dhe pastaj stërmëshur në përditshmëri me përsëritje të çdo aspiranti për vëmendje publike në betimin e tij/saj si më proamerikan se të tjerët - ka një përlllogaritje frike që rrjedh nga një skenar - andralle: Çka nëse një mëngjes presidenti Trump zgjohet dhe sheh se Kosova nuk ka blerë mall të mjaftueshëm amerikan dhe deklaron se më nuk do ta mbrojë Kosovën?

4.

Pra jo, lexuesi kolektiv kosovar i “Financial Times” nuk do të merret me faktin se rënia e tregut ndërkombëtar të aksioneve po e tregon rrezikun e recesionit të ekonomisë botërore, që nënkupton më pak qarkullim ekonomik, më pak para për kosovarët jashtë vendit, më pak remitencë dhe më pak investime në ndërtim të qyteteve të Kosovës dhe më pak para për të shpenzuar gjatë vizitave të verës, pra kurrrje të ekonomisë kosovare.

Lexuesi kolektiv kosovar i “Financial Timesit” është po ai i cili ende e ndien frikën e luftës dhe merret me përjetimin e tij të thjeshtë të një kthese potenciale dramatike botërore: Pra, nëse presidenti Trump po i jep fund garancisë amerikane për tregti të lirë (madje edhe miqsh), a do të thotë se do t’i japë fund edhe garancisë amerikane për mbrojtje të miqve?

Në emocionin kolektiv kosovar, kjo është dyfish më e rëndë, për shkak se kemi të bëjmë me popullin më proamerikan në Evropë, e mbase edhe aty diku në majat në nivel botëror.

5.

Procesi është i vështirë dhe mënyra më e mirë për ta përshkruar është se busulla amerikane e rendit të vjetër, e ndërtuar prej vitit 1945, nuk është më dhe busulla e re nuk është dizajnuar, por po testohet me veprime dekonstruktive, siç janë tarifën.


Reagimi i parë kosovar, ai i panikut me tarifën, duhet të zëvendësohet me analizë të esëllt. Në vend të panikut, analiza duhet të identifikojë mënyrën se si Kosova merr më shumë përgjegjësi dhe iniciativë në relacion me SHBA-në (në të gjitha fushat strategjike, prej energjisë të mbrojtja), por gjithashtu mënyrën se si Kosova integrohet në politikën strategjike evropiane, prej energjisë e deri te mbrojtja.

Në fakt, paniku duhet të zëvendësohet me konstatimin e thjeshtë - tashmë të shqiptuar prej presidentit Trump dhe të kuptuar prej liderëve evropianë - se roli garantues amerikan, prej tregjeve të hapura e deri te mbrojtja e Evropës, nuk duhet konsideruar si i mirëqenë. Dhe ky konstatim, siç po bëhet gjithandë Evropës, duhet të shtyjë një proces marrjeje përgjegjësie dhe krijimi të ideve të reja. Kosova duhet të hyjë në këtë proces.



NA KOTAKTONI

0 7947 785174



SHERBIME Te TONA

NDIME FIZIKE

Ne Jemi Krenare Qe Ju Sherbejme Me Ekipin Tona Profesional Multidisiplinor Te Perbera Na Eksperta

SHENDETI MENDOR

Klinika Medi-Park Clinic Esht Ketu Tju Ndhimuar Ne Perminesime e Cilesise Se Jetes Tuaj . Rikuperimi Esht i Mundur

BUKURI DHR ESTETIKE

Medi-Park Beauty Ofron trajtime Bukurie Tradicionale Dhe Moderne Esteritike per meshkujt Dhe Per Femrat

DIAGNOSTIKA

Ne kryjme Nje Game Te Gjere Testesh rUTINE Ne laboratorin Tone. Si Dhe tESTE te Specializuara Me partneret Tona te Cilet jan Laboratore Te Akreditura Nmare Ne UK



INFORMACIONE KONTAKTI

Ne kudesimi
Per Shendetin
Tuaj

HAPUR
7 DIT
NE
JAVE

Numer Telefon
020 8341 3185

E-mail Address
Info@mediparkclinic.uk

Aandresa Jone
573 Green lanes, Harringay, London
N8 0RL

Oraret Sherbimet
te Henen. Shtunen:- 9 am - 7 pm
Te Dielen : 11 am- 6 pm



CHECK-UP

MEDIPARK 2023

VETEM
£249

GP Consultation

BMI & Body Composition

Vital Checks

- BP
- Temperature
- Pulse
- Oxygene Saturation

Urinary Analysis

ECG

Full Blood Count

Liver Function Tests

Bilirubins, Alk Phos, AST, ALT, Gamma GT,
Total Protein, Albumin, Globulin

Kidney Function Tests

Urea & Electrolytes (Sodium + Potassium + Chloride)
Bicarbonate + Creatinine + eGFR

Fasting Glucose



Te gjitha e Ballkanit ne nji Market produktet

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059



A DËSHIRONI TË BËHENI ELEKTRIÇIST I KUALIFIKUAR?

A DËSHIRONI GOLD CARD?



**18 edition - Level 3 Award in the
Requirements for Electrical
Installations BS 7671:2018**

**EAL Level 3 Award in Electrical
Installation Inspection,
Testing, Certification and
Reporting 603/2625/6**

**501/1605/8 Installing
Electrotechnical Systems and
Equipment NVQ**

**AM2 Assessment of
Occupational Competence**



**www.collegeoflondon.org.uk
info@collegeoflondon.org.uk**

